



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Maj 2009 • Viti XXVI • Nr. 5 (175) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



Papa në Tokën e Shenjtë

FAQE 5

Përgatiti:
DON PAL TUNAJ



Veprimi i Shpirtit Shenjt në jetën dhe në misionin e Kishës

FAQE 8-9

Shkruan:
DON ANTON UKAJ



Të rinjtë dhe të tjerët?

FAQE 18

Shkruan:
BASHKËSIA SALEZIANE



Fëmija - sfidë jete dhe dashurie

Don Lush GJERGJI

Një qershori është dita botërore e kushtuar fëmijës dhe ka për qëllim vlerësimin e gjendjes së tyre në botën e sotme. Ajo për shumë aspekte dukshëm është ndërruar dhe përmirësuar, së paku në botën e demokracisë dhe të begatisë materiale, sa i përket shëndetësisë, veshmbathjes, banimit, shkollimit, kujdesit të familjes dhe të shoqërisë për lindjen, rritjen, zhvillimin dhe edukimin e tyre.

Mirëpo fatkeqësisht ka ende shumë sfida dhe rreziqe për jetën e fëmijëve, duke u nisur prej abortusit (dështimit), që është mungesa themelore e të drejtës në jetë, deri te dhuna, keqtrajtimi, pedofilia, pornografia, shëndetësi i të rriturve, braktisja, shkurorëzimi i prindërve, manipulimet gjenetike... që bindshëm dëshmojnë mungesën e dashurisë për jetën e re.

Ndoshta sot më shumë se kurrë më herët fëmijët janë të kërcnuar dhe të rrezikuar nga vetë prindërit, si dhe nga shoqëria moderne e cila kryesisht mbështetet në punë, fitim, mirëqenie materiale, dhe si e tillë zhvillon “kulturën e vdekjes” duke jetuar gjithnjë në ankth dhe në frikë të dyfishtë, prej jetës së re të fëmijëve dhe prej pleqërisë dhe vdekjes.

Për ne të krishterët çdo fëmijë, jetë e re, është krijesa më e bukur e dashurisë së Zotit dhe e bashkëpunimit dhe bashkëkrijimit të prindërve, thirrje e dyfishtë në jetë, atë fizike dhe shpirtërore. Mu për këtë çdo kundërshtim i jetës së re, sidomos dështimi, për ne është vrasje e jetës së pambrorë të fëmijëve të palindur dhe të pafajshëm.

E Lumja Nëna Tereze në Universitetin katolik të Milanos “Zemra e Krishtit”, pasi e kishte pranuar Doktoratin e Nderit në Mjekësi (1981) ndër të tjera pati thënë kështu: “Dështimi është varfëria më e madhe e botës së sotme. Dështimi nuk është asgjë tjetër përpos frika nga jeta e fëmijës. Frika për ta ushqyer, edukuar, sidomos për ta dashur një krijesë të re... Fëmija i parë që e njohi Jezusin ishte Gjon Pagëzuesi ende i palindur në krahërorin e Elizabetës... Nëse nuk e doni ju fëmijën tuaj, ma dhuroni mua... Dashuria është fryti i çdo stine...”.

Shkrimtari i madh Tagore pati shkruar: “Deri sa të çelin lulet dhe lindin fëmijët domethënë se Zoti nuk ka hequr dorë prej njerëzimit”. Bukur dhe ngushëlluese! Lulet ende po çelin, edhe pse natyra është gjithnjë më e ndotur dhe rrezikuar. Fëmijët ende po lindin, gjithnjë më pak, sidomos në botën “moderne” e të pasurëve, por të varfër, mos të them të njerëz, në anën shpirtërore...

Sigurisht se Zoti nuk hoqi dorë prej njerëzimit, por ndoshta njerëzimi është në rrezik të heq dorë prej Zotit, burimit të Jetës dhe të Dashurisë, prandaj edhe prej vetvetes!

Jezusi thotë: “Leni fëmijët të vijnë tek unë e mos i ndaloni: sepse atyre u përket Mbretëria e Hyjit” (Mk 10, 14; krh. Mt 19, 13-15; Lk 18, 15-17).

Ndoshta sot Jezusi do të thoshte kështu: LENI FËMIJTË TË LINDIN, TË RRITEN, SEPSE....

Pranimi i jetës është parakusht për pranimin e Zotit dhe vullnetit të Tij, fillim i bashkëpunimit dhe bashkëkrijimit me Të. Ku mungon jeta, mungon edhe Dashuria – Zoti, flijimi, dhurimi që paraprijnë dhe përgatisin lumturinë, pavdekësinë, amshimin.

Pali është misionari më i dalluar i Krishtit në historinë e njerëzimit

FAQE 14-15

Shkruan:
Don Marjan UKAJ, Toronto

Bisedë me Prof. Engjëll I. Berishën, aktivist në Shoqatën për të Zhdukur “27 Prilli 1999-Mejë” në 10-vjetorin e Masakrës së Mejës dhe Korenicës

Masakra e Mejës dhe Korenicës i ka dritaret sy të nënave që presin t’u kthehen të vdekurit për ta pajtuar dhembjen

FAQE 12-13



Don Lush Sopi u shpallë “qytetar nderi” i Mitrovicës

Don Lush Sopi: “Kush e vlerëson të kaluarën di të ndërtojë të ardhmen”

Në fillimprillin e këtij viti, Mitrovica dhe qytetarët e saj kishin një kremte të madhe. Ata, edhe një herë me pietet për kujtuan golgotën biblike të vitit 1999, kur popullata e këtij qyteti dhe të rrethinës nga forcat polikore e ushtarake serbe dhunshëm ishin dëbuar nga vatrat e tyre shumëshekullore dhe kishin gjetur ndihmën e Kishës Katolike të Zllakuqanit dhe të popullatës së këtij lokaliteti dhe të Lugut të Drinit në përgjithësi.

Me këtë rast, edhe një herë u shpallën ato vite të trishita me esencat e saj tragjike, por edhe u shprehën mirënjohje për të gjithë ata që në ato kohëra të rënda iu gjenden pranë kësaj popullate për ta mbijetuar atë gjendje.

Kështu, në një ceremoni rasti, në sallën e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës u organizua një seancë solemne, ku me këtë rast për ndihmën e ofruar të të përndjekurve gjatë luftës së vitit 1999, nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, përkatësisht Kuvendi i Komunës së këtij qyteti, don Lush Sopi, aktualisht famullitar në kishën katolike “Shën Rrokut” në Novosellë të Gjakovës, është laureuar me titullin “Qytetar nderi” i Mitrovicës, që është shprehje e mirënjohjes për gjithë kontributin që ai ka dhënë popullatës së Mitrovicës dhe të rrethinës gjatë kësaj lufte.

Me këtë rast nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës janë dhënë mirënjohje edhe për don Marjan Demajn, në atë kohë ish famullitar në Kishën “Shën Gjergji” në Budisalc, si dhe për përfaqësuesit të fshatrave Zllakuqan, Zabllaq, Gremnik, Xërxë dhe për kryetarin e Bashkisë së Kukësit për mirëpritjen e treguar.

Seancën solemne e udhëhoqi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Ahmet Tmava, i cili



Don Lush Sopi shpallë “qytetar nderi” i Mitrovicës

që në fillim të pranishmëve u shprehi mirëseardhje në këtë moment shumë solemne e të madhërishtëm. Kryesuesi Tmava në vazhdim lexoi një biografi të don Lush Sopit. Ndërkaq, në emër të Iniciativës qytetare të Mitrovicës të pranishme iu drejtua kryetari i kësaj iniciative, Dr Shaqiri Demiri, i cili theksoi se dhjetë vjet më parë Kosova ndodhej nën etheet e tmerrit të paparë nga dhuna dhe përndjekja e popullatës shqiptare nga policia, ushtria dhe paramilitarët serb.

Ndërkaq kryetari i komunës Bajram Rexhepi, i cili don Lush Sopit i dha titullin “Qytetar nderi” dhe mirënjohje për ata që i kanë ndihmuar qytetarët e dëbuar të Mitrovicës gjatë luftës së vitit 1999, e vlerësoi heroike ndihmën që kishin ofruar popullata dhe klerikët fetarë për të dëbuarit gjatë viteve të luftës. Kryetari Rexhepi me rastin e ndarjes së titullit “Qytetar nderi i Mitrovicës” për don Lush Sopin, u shpreh se iniciativën për ndarjen e titullit “Qytetar nderi i Mitrovicës” për priftin don Lush Sopi dhe mirënjohjen për priftin don Marjan Demaj e kam pranuar me shumë kënaqësi. I nderuari zotëri Sopi, personaliteti juaj sublimon shpirtin solidar të bashkëfshatarëve të juaj

dhe të bashkëkombëseve tonë në përgjithësi. Këtë solidaritet ia dëshmuat me veprë mijëra qytetarëve të Mitrovicës, të cilët u dëbuan me dhunë dhe u depërtuan për në Shqipëri gjatë luftës së fundit. Titullin “Qytetar nderi i Mitrovicës” për priftin don Lush Sopi, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës e ka aprovuar më datën 13 tetor 2008 dhe unë kam nderin që këtë vendim ta lexoj para ju: Duke u bazuar në nenin 40.2 al. H të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në nenin 8.1 dhe 28.1, alineja j të Statutit të Komunës së Mitrovicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 13.10.2009, unanimisht mori vendim, që priftin don Lush Sopi t’i jepet titulli “Qytetar nderi të Mitrovicës”. Prifti don Lush Sopi, ish-famullitar i Kishës së Zllakuqanit dhe priftit don Marjan Demaj, ish-famullitar i Kishës së Budisalcit me tërë qenien e tyre prej patriotëve, humanistëve dhe misionarëve fetarë iu përkushtuan në mënyrën më vëllazërore përkujdesjes ndaj qytetarëve të Komunës së Mitrovicës në strehimin, sigurimin e ushqimit, veshmbathjes, shërimin e plagëve dhe rehabilitimin e të traumatizuarëve nga dhuna dhe gjenocidi i ushtrisë dhe paramilitarëve serbë në vitin 1999”, thuhet në këtë vendim të nënshkruar nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Z. Bajram Rexhepi.

Qytetari i nderit i Mitrovicës don Lush Sopi, në fjalën e tij u shpreh se ata që dinë ta vlerësojnë të kaluarën e kanë të ardhmen e sigurt. Ai shprehu mirënjohjen për lareuimin e tij me këtë titull të lartë, të cilin e cilësoi nder dhe privilegj.

Në përfundim mund të konstatojmë se e tërë kjo ngjarje u përshkua në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore.

(Mikel Gojani)

U kremtua festa e “Shën Jozefit Punëtor” në Pjetrashan

Kambanat e reja, të ardhura nga Austria, u sollën gëzim të gjithë besimtarëve!

Një maji, festa e Shën Jozefit punëtor, si çdo vit tjetër, edhe në këtë vit bashkoj një masë të madhe të popullit nga të gjitha viset e Kosovës e në mënyrë të veçantë nga rrethi i Gjakovës. Kjo është famullia më e re e Administratës Apostolike të Prizrenit, por do të thoja, njëkohësisht edhe famullia më atraktive sepse posedon një peizazh dhe natyrë të mrekullueshme. Kjo specifikë bëhet e veçantërisht e dukshme në stinën pranverore, mu për këtë edhe për të kremten e pajorit të kësaj famullie.

Mëshën kryesore e udhëhoqi ish famullitari don Franë

e shtoj pa masë gëzimin e kësaj feste.

Me dallim me vitet e kaluara, në këtë vit festës së Shën Jozefit në famullinë e Pjetrashanit, ju shtua edhe gëzimi i kambanave të reja që arritën nga Austria. Këto kambana janë kontribut i bijëve tanë që jetojnë dhe veprojnë në Gjermani, Zvicër, Austri dhe në vendet e tjera të Evropës dhe Botës. Por meritë për këto kambana ka pa dyshim edhe famullitari i kësaj famullie don Tomë Karrica, me iniciativën e të cilit u grumbulluan mjetet materiale dhe blerja e tyre. Transportin e këtyre kambanave e bëri K-FOR-I Austriak. Besimtarët ishin kureshtar ti shikonin kambanat dhe në pritje që sa më shpejt të behët montimi i tyre dhe të ndihet tingëllima e këtyre kambanave. Këto Kambana më këtë rast i bekoj ish famullitari i kësaj famullie don Franë Kola.



Gjatë kremtimit të meshës



Kola, tani famullitar i famullisë se Velezhës dhe delegat i përgjithshëm për Administratën Apostolike të Prizrenit. Ai në fjalën e rastit ilustruoi rëndësinë e jetës dhe veprës së Shën Jozefit dhe në mënyrë të veçantë theksoi rëndësinë e punës duke nxjerrë në pah sidomos të vërtetën biblike, pastaj atë të traditës së kishës e deri në interpretimin e rasteve konkrete të kohës në të cilën jetojmë dhe veprojmë ne. Ishte kjo një ditë pak e veçantë nga se gjithë shpresonim të përjetonim rrezet e diellit, por kjo nuk ndodhi, pasi që në këtë ditë moti ishte shumë i ftohtë dhe më shi. Më gjithë këtë dhuratë të madhe për bujqit, besimtarët të mbrojtur prej ombrellave të tyre, e përcjellën me devotshmëri meshën shenjte dhe u ndien jashtëzakonisht të lumtur në këtë kremtim eukaristik. Edhe kori i famullisë, i udhëhequr nga motrat françeskane të Zojsë se papërljer, me këndimin e bukur



Ndërsa sipas një tradite kumbare i këtyre kambanave u zgjedh bamirësi dhe biri i kësaj famullie Gjon Domgioni, i cili jeton dhe vepron në Gjermani.

Në fund famullitari i kësaj famullie don Tomë Karrica, në emër të të gjithëve shprehi faleminderimet për të gjithë duke filluar prej të madhit Zot deri tek kontributi më i vogël që e zbukuroi dhe e mundësoi kremtimin e kësaj feste. Ndërsa për të ftuarit famullitari shtroj sofrën vëllazërore, e në këtë mënyrë edhe besimtarët hapen dyert dhe zemrat e tyre për shtegtarët dhe mysafirët e ndryshëm të ardhur prej viseve të ndryshme.

(Dritapress)



U kremtua festa e "Shën Nikollës" në famullinë e Velezhës

Don Lush Gjergji: "Me shekuj të tërë në popullin tonë shqiptar u ruajt dashuria dhe nderimi për shenjtërit dhe shenjtëreshat e Hyjit...!"

Është për tu mrekulluar dhe për të falënderuar Zotin e gjithëpushtetshëm për dashurinë dhe fenë e madhe që e mbjellë dhe e kultivon në shpirtin e besimtarëve tanë. Kjo fe dhe dashuri dëshmohej kur me mijëra besimtar nga e tërë treva kosovare dhe më gjerë vijnë për të nderuar me shumë devotshmëri bariun, ipeshkvën dhe mrekullibërësin Shën Nikollën e Barit. Kjo ngjau pikërisht të dielën e pestë të pashkëve me 10 maj në famullinë e Velezhës. Me mijëra besimtar erdhën për të kërkuar ndërmjetësin e këtij shenji dhe mrekullibërësi. Këtë bashkim të besimtarëve në mes veti dhe më Zotin e favorizoj edhe moti jashtëzakonisht i mirë lirisht të themi veror.

Mesha kryesore u kremtua në ora 11:00, të cilës i priu famullitari i Katedrales dr. Don Lush Gjergji. Se bashku me don Lushin koncelebruan edhe shumë meshtar tjerë në veçanti të theksojmë praninë e don Anton Kçira, misionar në Detroit-USA. Don Lushi ashtu sikur u prit me kureshtje nga besimtarët e vet, po me aq vullnet dhe entuziazëm u dëgjuan edhe fjalët e predikimit të tij. Ishin fjalë të menduara mirë dhe të zgjedhura për besimtarët. Ishin fjalë që prekën jetën dhe zemrën e të pranishmëve. Ai ilustroi në mënyrë shumë të theksit jetën e këtij shenji duke e ngrit në dukje



Don Frana, don Lushi, don Anton Kçira dhe meshtarë të tjerë në koncelebrim

veprën, jetën dhe shembullin e Shën Nikollës dhe duke ftuar të gjithë besimtarët që të ndjekin po të njëjtat gjurmë. Don Lushi theksoj faktin që për Shën Nikollën pasuria me madhe ishte Zoti, feja, Kisha dhe vlerat që ato mbajnë në vete. Prandaj edhe besimtarët duhet të ikën prej dëshirës se pasurimit nëpër mjet mënyrave të ndyta siç është prostitucioni, trafikimi i qenieve njerëzore, drogës dhe mashtrimeve tjera të mundshme. Ishte ky një predikim shumë i afërt për popullin dhe që la shumë mbresa. Në fund të meshës famullitari i kësaj famullie don Franë Kola, në emër të besimtarëve të famullisë e falënderoj Zotin për ditën e mirë, falënderoj predikatarin për fjalët e tij të zgjedhura, të du-

hura, dhe të nevojshme. E falënderoj pa masë misionarin tonë në Detroit don Anton Kçirën, për praninë e tij dhe e potencoi në këtë rast gjithë kontributin e tij për kishën, për besimtarët e në mënyrë të posaçme për popullin tonë shqiptar gjatë momenteve me të vështira të luftës. Prania e don Anton Kçirës dhe kontributi i tij u pëlqye dhe u mirëprit me një duartrokitje nga ana e besimtarëve. Don Frana falënderoj edhe korin, rend-mbajtësit dhe të gjithë ata që kontribuuan që kjo festë të realizohet sa më mirë. Krejt në fund ai ftaj që besimtarët më këtë shpirt dhe të shpërndahen nëpër shtëpitë e tyre. Atmosferën festive e përmbylli dreka vëllazërore që e shtroj famullitari dhe e përga-



Besimtarët gjatë kremtimit të meshës në Velezhë

titën më shumë dashuri motrat françeskane. Kështu vepruan edhe familjet bujare të famullisë se Velezhës.

Sallagrazhdë - Një ditë me parë, pikërisht me 09 maj festa e Shën Nikollës u kremtua edhe në filialin e kësaj famullie në Sallagrazhdë. Atje meshën e udhëhoqi don Pal Tunaj, kapelan

në famullinë e Klinës. Don Pali me entuziazmin e një meshtari të ri u predikoj të pranishmeve jetën dhe veprën e Shën Nikollës. Edhe kjo festë u festua me një gëzim të veçantë. Mirë u pafshim nëpër festa dhe kremtime të ipeshkvisë sonë!

(Dritapress)

Të ngjiturit e Krishtit në qiell – DITA E SHËLBUEMIT

Filiala e Doblibarës të Enjten me 21 Maj 2009 në Bërdosën e kremtoi festën e vet: Ngritjen e Krishtit në Qiell. Meshën e udhëhoqi famullitari i famullisë së Shën Jozefit në Pjetrashan don Tomë Karrica. Së bashku me don Tomën në meshë koncelebruan edhe don Rrok Gjollshaj, famullitari i Bishtazhinit, patër Ndue Kajtazi Frat i Gjakovës dhe don Kolë Thaqi Famullitari i Doblibarës.

Predikimi ishte kryekëput për ngjarjen e ngritjes së Krishtit në Qiell. Atje Krishti shkoi për të

na përgatitë vendin edhe neve që besojmë në të. Atdheu ynë është Qielli, u shpreh don Toma.

Edhe pse dielli ishte shumë i fortë, besimtarëve nuk ju pengoi që me kujdes ta përcjellin meshën dhe të marrin pjesë në mënyrë të denjë në misteret e Eukaristisë.

Kështu Krejt në fund Don Kola i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit në meshë, korin e në veçanti meshtarët që ishin në disonim të besimtarëve për rrefim.



Kremtimi i meshës së Shëlbuemit në Bërdosën

Imzot Dodë GJERGJI në New York

Më 17 maj Imzot Dodë GJERGJI i përcjellur nga Don Franë KOLA dhe Don Lush GJERGJI kremtoi Meshën në kishën "Zoja e Shkodrës" së bashku me Don Pjetër POPAJ dhe Don Viktorin.

Në mbërmje të asaj dite në Hotelin MAESTRO's ishte DARKA E KATEDRALES "Nënë Tereza" në Prishtinë me pjesëmarrje të afro 500 shqiptarëve nga të gjita trojet dhe përkatësitë fetare tona. Darkën e bekoj Don Franë Kola. Pas himnit kombëtar amerikan dhe shqiptar të pranishmit i përshëndeti Ismer MJEKU, pastaj folën Don Pjetër Popaj, Imzot Dodë Gjergji, Don Lush Gjergji, Joseph DIOGUARDI dhe kryetari i Këshillit për ndërtimin e Katedrales, Marjan CUBI. Programi muzikor ishte në nivel të lartë artistik me pjesëmarrje të Nermin Daja ZHABLJAKU, Kreshnik ZHABLJAKU, Aurela GAÇE, si dhe recitalin anglisht - shqip kushtuar Nënës Terze të Arlinda BËLIDEMAJ dhe Frashër UKAJ.

Takimet, afrimet, bashkimet e tilla dëshmojnë edhe një herë vëllazërinë gjithshqiptare, bujarinë, përkrahjen dhe pjesëmarrjen e bashkatdhetarëve tanë kudo në botë për ndërtimin e Katedrales "Nënë Tereza" në Prishtinë.

(Dritapress)

U mbajt Turniri tradicional "Imzot Mark Sopi"

Të shtunën, më 23 maj në sallën e sportit në Gjakovë u zhvillua turniri tashtë tradicional i Kishës sonë lokale, që mbanë emrin e ipeshkvit të ndier mons. Mark Sopi. Ky takim tashtë është bërë një datë e rëndësishme për mbarë rininë katolike dhe zë një vend të veçantë në aktivitetet rinore që kisha katolike i organizon për rininë

këtë manifestim mbretëro një atmosferë e mirë vëllazërore dhe shoqërore. Lojërat u zhvilluan sipas tërheqjeve të shortit dhe duke i respektuar të gjitha rregullat e parapara nga vet rregullorja e këtij turniri. Turniri zgjati pothuajse tërë ditën deri në ora 22 ku përfundoj me takimin final. Para finales këtë tubim e përgëzoj dhe e përshëndeti edhe i pari

e Bistazhinit më shumë meritë e mori vendin e parë, Stublla të dytin, ndërsa Pjetrashani vendin e tretë. Dhe në fund udhëheqësit e meshtarëve dhe i pari i komunës ndanë fituesve shpërblimet. Nuk guxojmë të harrojmë gëzimim e madh dhe spektaklin e mahnitës të tifozerisë bistazhinase e cila e ngriti atmosferën dhe e bëri me të hareshëm edhe



Ekipi i Bistazhinit - fitues i turnirit

tonë. Edhe kësaj radhe, si në vitet e kaluara ky aktivitet u prit me entuziazëm dhe u përjetua shumë mirë nga të gjithë pranishmit. Në këtë aktivitet morën pjesë më së njëzet ekipe nga e gjithë Kosova. Shorti për zhvillimin e lojërave më qen se ishte hedhur 5 ditë më parë, atëherë në ora 9 e 30 më një herë startoi zhvillimi i lojërave. Udhëheqës të këtij aktiviteti sportiv ishin meshtarët: p. Anton Nua, don Lush Sopi, don Tomë Karica, dhe don Jeton Thaqi; ndërsa nga ana e laikëve ishin Dr. Pashku nga Gjakova, Reshat Idrizi nga Binça. Gjyqtaret ishin profesionist në kuadër të super-ligës. Në

i komunës se Gjakovës z. Dr. Pal Lekaj, i cili se bashku me një grup zyrtarësh komunal zhvilluan një ndeshje miqësore me skuadrën e meshtarëve të Administraturës apostolike të Prizrenit. Si kuvendaret komunal, ashtu edhe meshtarëve u mungonte kondicioni, por nuk u mungonte aspak vullneti për të krijuar ura dhe momente të hareshme edhe nëpër mjet aktivitetet të këtij lloji. Më gjithatë kuvendaret komunal morën fitoren kundër ekipit të meshtarëve. Pas këtij takimi miqësor u zhvillua edhe takimi final ndërmjet famullisë se Stubllës dhe famullisë se Bistazhinit. Kështu që famullia

vet këtë manifestim. Turniri përfundoj pa asnjë problem duke ju falënderuar edhe mbajtjes se normave të këtij turniri. Ishte një ditë e bukur për të gjithë, rinia kanë nevojë për këso ditësh takimi, bashkimi dhe njoftimi njëri me tjetrin. Pra shpresojmë dhe urojmë që në të ardhmen të ketë sa më shumë takime të mira dhe qofshin ato sportive e në përgjithësi kulturore për rininë tonë. Vendit të parë, dytë dhe të tretë i urojmë fitoren dhe të gjithë pjesëmarrësve të këtij turniri i dëshirojmë shumë suksese dhe bekime prej Zotit. Mirë u pafshim në vitin e ardhëm!

(Dritapress)

Lutjet shpirtërore në Bishtazhin

Muaji Maj është i veçantë për famullinë e Zojës Ruzare, sepse pas më shumë se 18 vite lutjesh dhe kërkesë për mbajtjen e një seminari të tillë, kjo dëshirë u realizua me ndihmën dhe insistimin e famullitarit Don Rrokut. Kështu theksoi prijësi fetar i këtij seminari Dr. Don Prekë Lazri, njëherësh edhe drejtor i radio Marisë.

Seminari zgjati 5 ditë dhe numri i besimtarëve çdo ditë e shtonte pjesëmarrjen në lutje dhe meditim.

Gjatë këtij pesëditëshi, besimtarët nuk ishin veç nga famullia e Bishtazhinit, por vinin edhe nga famullitë tjera të rrethinës që përbënin një numër të madh besimtarësh. Por, përqindjen më të madhe të pjesëmarrësve e përbënin nënat, të cilat, përkundër moshës dhe obligimeve të tyre, e ndoqën thirrjen e Zojës Ruzare dhe nevojën për t'u lutur që brezat e tyre të jenë sa më të gjallë në fëmë Krishtin.

Është folur gjerë e gjatë mbi jetën biblike, mbi vet jetën dhe mrekullitë e Krishtit, mbi jetën njerëzore të jetuar dhe shembujt e mirë që jeta jonë t'i përkasë dëshirës së Zotit. Por, fatqeqsisht, jeta e jonë njerëzore nuk përkon sa duhet me atë që Krishti kërkon. Por, ja, mrekullia ndodhi, Krishti u ndie i gjallë në mes të besimtarëve, sepse në ditën e tretë të seminarit gjatë 30 min të meditimit të ndezur nga flaka e fesë, nga emocionet, gëzimi dhe përjetimi i lutjes kanë shprehur ndjenjën e fortë shpirtërore tek disa besimtarë që kanë lutur me zemër të hapur Zotin që bota të ketë një kuptim njerëzor, që



Don Prenka gjatë fjalimit

familja të jetë e shëndoshë dhe e bashkuar, që të ketë paqe në mes njerëzve dhe jeta e tyre të kthehet kah rruga e drejtë dhe e vërtetë.

Madhështia e seminarit qëndron te ripërtëritja shpirtërore e besimtarëve dhe tek meditimi mbi mëkatet e bërë nga lëshimet njerëzore dhe trupore, si dhe pastrimi i tërësishëm i ndërgegjes me anë të sakramentit të rrëfimit, ku në dispozicion të rrëfimit ishin mbi 10 priftërinj dhe mbi 700 besimtarë që kishin ndjekur çdo ditë lutjet.

Mirësia dhe mrekullia që ka ndodhur në jetën e shumë besimtarëve është e papërskruar, lehtësia shpirtërore dhe rikthimi i së vërtetës nuk mund të shkrutet me anë të fjalëve, është emocioni i jetuar...- kështu janë shprehur pjesëmarrësit e këtij seminari.

Dhasht Zoti që seminare të llojit të njëjtë të mbahen sa më shumë edhe në famullitë tjera nevojtare të Kosovës.

(Antoneta Shtufi)

Festa e Zojës ndihmëtare në Katedralen e Prizrenit

Të dielën, më 24 maj, në Kishën katedrale të Prizrenit u kremtua festa e Zojës Ndihmëtare, pajtore e famullisë së Prizrenit dhe e Ipeshkvisë sonë.

Muaji i majit, siç është traditë pothuajse në të gjitha famullitë e Ipeshkvisë sonë, u kushtohet në mënyrë krejt të veçantë lutjes dhe nderimit ndaj Zojës së Bekuar. Edhe në famullinë e Priz-

renit pjesëmarrja e besimtarëve gjatë këtij muaji në ruzaren, në meshën shenjte dhe në bekimin më të Shjetnueshmin Sakrament ishte pothuajse si ajo e të dielave të zakonshme.

Festës së famullisë i parapriu një përgatitje më intensive gjatë treditëshit, të cilin e filloi don Tomë Karica ish famullitari i Prizrenit; ditën e dytë e vazhdoi

don Rrok Gjonleshaj famullitar i Bistazhinit dhe natën e festës Meshën shenjte e udhëhoqi famullitari i Prizrenit don Lush Gjergji. Besimtarët e famullisë gjatë tërë muajit të majit dhe veçanërisht në treditëshin, u përgatitën edhe përmes sakramentit të rrëfimit, në mënyrë që të kremtojnë sa më mirë festën e Zojës Ndihmëtare.

Në ditën e festës, qysh në meshën e parë të mëngjesit, besimtarët filluan të vijnë nga famullitë e ndryshme me mjetet dhe falënderimet e tyre ndaj Zojës së Bekuar. Meshën kryesore e udhëhoqi don Shan Zefi famullitar në Zym dhe njëherësh edhe Kancelar i Ipeshkvisë. Don Shani, në pretkun e rastit, me përsipirtëshmëri, me qartësi dhe me një dashuri të flaktë pushtoi zemrat e të gjithë të pranishmëve. Ai ceku dhe lartësoi ndihmën dhe mbrojtjen që Zoja e Bekuar



tregoi gjatë historisë dymijëvëçare të Kishës në përgjithësi.

Prania e madhe e besimtarëve dhe këndimi i mrekullueshëm i korit të famullisë, e bëri edhe më madhështore atë ditë feste dhe ngrohësie për të gjithë besimtarët e famullisë së Prizrenit.

Në fund të meshës, famulli-

tari i Prizrenit don Lush Gjergji, në emër të meshtarëve dhe motrave që shërbejnë në Prizren, përshëndeti, falënderoi dhe i uroi të gjithë të pranishmit, që ndërmjetësia dhe ndihma e Zojës së Bekuar të jetë gjithmonë në zemrat dhe familjet e tyre.

(Dritapress)



Kremtimi i festës së Zojës Ndihmëtare në katedralen e Prizrenit

Papa në Tokën e Shenjtë

■ PËRGATITI:
Don Pal TUNAJ

Hyri në Tokën e Shenjtë, nëpërmjet vendit të hapur në Lindjen e Afërt, Jordanisë së mbretit Abdullah II, një vend i cili nuk frikësohet nga dialogu, një vend të cilin e ka udhëhequr urtia e mbretit të njohur Hysen, që kërkonte rrugë të ndërmjetësimit në etapat më të përgjakshme të shekullit të kaluar që kanë ngritur grupe terroriste që janë shenjë e urrejtjes ndërfetare, etnike, të cilat e komprometojnë ardhmërinë.

Jordania është një pikë e rëndësishme për ekuilibrin e Tokës së Shenjtë.

Më 8 maj filloi shtegtimi dhe vizita e parë e Papës Benedikt XVI në Lindjen e Mesme – në Tokën e Shenjtë. Së pari filloi me vizitë në Jordani ku u prit nga Mbreti i Jordanisë Abdullahu II dhe krerët shtetërorë e fetarë të të tri bashkësive – të krishterëve, myslimanëve dhe hebrejve, me të cilët u përgëzua për tolerancën fetare. Pas përshëndetjes në aeroport filloi vizita në kështjellën mbretërore, ku u prit nga mbreti Abdullah dhe familja mbretërore. Të shtunën beri vizitat në Bazilikën Memorialë të Moisiut, u takua edhe me krerët fetarë myslimanë.

Brohoria e Papës pranë Varrit të Shenjtë: Krishti u ngjalli! Këtu ndryshoi historia!

Krishti u ngjalli! Është brohoria e Benedikt XVI drejtuar sot mbarë botës para varrit të zbrazët të Jezusit në Bazilikën e Varrit të Shenjtë. 'Këtu – tha Papa – historia e njerëzimit ndryshoi përfundimisht. Sundimi i gjatë i mëkatit dhe i vdekjes mori fund. Mbi të ngadhënjëu bindja e jeta. Druri i Kryqit tregon të vërtetën për të mirën e për të keqen; gjykimi i Zotit për këtë botë u shpall e hiri i Shpirtit Shenjt u ndikua mbi mbarë njerëzimin. Këtu Krishti, Adami i ri, na mësoi se e keqja nuk do ta thotë kurrë fjalën e fundit, se dashuria është më e fortë se vdekja, se ardhmëria jonë e ajo e njerëzimit është në dorë të një Zoti parashikues e besnik. Varri i zbrazët na flet për shpresë, për atë shpresë që nuk të zhgënjën kurrë, sepse është dhuratë e Shpirtit të jetës! Ky është mesazhi që dua t'ju lë, në përfundim të shtegtimin tim në Tokën e Shenjtë – tha Papa – e shtoi: "Kisha në Tokën e Shenjtë, që e ka provuar tepër shpesh misterin e Golgotës, nuk duhet

të pushojë kurrë së qeni lajmëtare syptrembur e mesazhit të ndritshëm të shpresës, që shpall ky Varr i zbrazët: "Si të krishterë, e dimë se pagja që dëshiron kjo tokë ka një emër: Jezus Krishti! Ai është pagja jonë, që na pajtoi me Hyjin në një korp të vetëm përmes Kryqit, duke i dhënë fund armiqësisë. Në këtë Varr të zbrazët – vijoi Papa – Kisha në Tokën e Shenjtë ftohet t'i varrosë të gjitha anketat e druajtjet, për të rilindur përsëri çdo ditë e për të vijuar shtegtimin nëpër udhët e Jeruzalemit, të Galileës e më tutje. Duke shpallur ngadhënjimin e ndjesës së Krishtit e premtimin e një jete të re". Kështu u shpreh Papa në Bazilikën e Varrit të Krishtit, në një nga vepërimitaritet e fundme të shtegtimin të tij apostolik në Tokën e Shenjtë.

Papa hyri me procesion në Bazilikën historike në qendër të Qytetit të Shenjtë, i shoqëruar nga një grup, që ecte me hapa ritmikë, duke i rrahur fort këmbët mbi dyshe. Tek porta e Bazilikës e pritën Etërit e Tokës së Shenjtë, përfaqësuesit e Kishës greko-ortodokse dhe armenë-apostolike, përgjegjës të 'statu quo' në Bazilikë. Në treme, tek këmbët e Golgotës, Papa u përkul për të puthur Gurin e Bagmit, pastaj, me emocion të dukshëm, hyri në Kapelëzën ku ruhet Varri i Shenjtë. U gjuhëzua mbi varrin, puthi rrasën, që e mbulon dhe u lut gjatë. Kundronte misterin e ngjalljes së Krishtit. Këtu Krishti vdiq e u ringjall, për të mos vdekur kurrë më – tha Papa – dhe në vijim u përcollti të gjithëve mesazhin e madh të shpresës: *Uroj që shpresa të lindë përsëri e përsëri, për hir të Zotit, në zemrën e çdo njeriu që jeton në këto toka. E të rrënohet në zemrat tuaja, që të jetoni pranë familjeve tuaja e bashkësive tuaja, e ta frymëzojë secilin nga ju për ta dëshmuar besnikërisht Princin e Paqes*. Ungjilli na thotë se Zoti mund t'i bëjë të reja të gjitha sendet, se historia mund të mos përsëritet, se kujtimet mund e duhen spastruar, frytet e hidhura të kundërpasive e të armiqësive mund të zhduken e se ditët e bardha të drejtësisë e të paqes, të begatisë e të bashkëpunimit mund të vijnë për çdo burrë e çdo grua, për mbarë familjen njerëzore e, në mënyrë të veçantë, për popullin që jeton në këtë tokë, aq të dashur për zemrën e Shëlbuesit. Në përfundim, Benedikti XVI e inkurajoi Kishën vendase të jetë dëshmitare e unitetit dhe e paqes për të gjithë ata, që jetojnë në Qytetin e Shenjtë. Më pas shkoi në Golgotë, për t'u lutur mbi atë vend ku dymijë vjet më parë u kryqëzua Zoti!



Benedikti XVI i drejtohet presidentit Abaz: Selia e Shenjtë mbështet të drejtat e palestinezëve. Dhe i porosit të rinjtë: larg tundimit të terrorizmit!

Papa u prit në Betlehem, në Territorët Palestinëze, nga presidenti i Autoritetit palestinez, Mahmud Abaz. Ceremonia e mirëseardhjes u mbajt në Sheshin përballë Pallatit presidencial. Mbas ekzekutimit të himneve, presidenti Abaz e përshëndeti Papën dhe e falënderoi për vizitën. Foli, më pas, për vuajtjet e popullit palestinez e, sidomos, për faktin se në këto troje ndërtohen mure e jo ura. Denoncoi kështu praninë e murit, që rrethon Jerusalemin e i pengon bijtë e Cisjordanisë të shkojnë për t'u lutur tek Varri i Shenjtë e tek Xhamia Al-Aksa, duke sanksionuar aneksimin izraelit të Jerusalemit arab. Por Jeruzalemi arab – shtoi presidenti Abaz – është kryeqyteti i përjetshëm i Palestinës. Palestinezët detyrohen të emigrojnë, shtëpitë e tyre bëhen rrafsh me tokën, trojet konfiskohen. Kushte këto, që na ngarkojnë me përgjegjësi



si, që kërkojnë të punojmë për krijimin e dy shteteve sovranë, Izraelit e Palestinës, të cilët duhet të jetojnë në paqe e stabilitet njëri pranë tjetrit. Presidenti palestinez kërkoj edhe zgjidhjen e problemit të refugjatëve, duke respektuar vendimet e OKB-së. Vuri, më pas, theksin, mbi tragjedinë e Gazës: jemi për paqen – theksoi presidenti Abaz – e vijojmë të shprejmë në një të nësërme, kur nuk do të ketë më as pushtim, as post-bloqe, as të burgosur e as refugjatë, por bashkëjetesë paqësore e mirëqenie. Papa iu përgjigj duke pohuar se Selia e Shenjtë mbështet të drejtën e popullit palestinez për të pasur një atdhe sovran në trojet e të parëve, që jeton në siguri e në paqe me fqinjët, brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht. *Ndonëse sot realizimi i këtij qëllimi duket i largët – tha Papa – unë ju inkurajoj ju e të gjithë popullin tuaj, ta mbani ndezur pishtarin e shpresës, pishtar që mund të ndihmojë për të gjetur udhën e takimit të aspiratave të ligjshme si të izraelitëve, ashtu edhe të palestinezëve për paqe e stabilitet.* Më pas Benedikti XVI kujtoi fjalët e Papës Gjon Pali II, për të ripohuar me forcë se: *“Nuk mund të ketë paqe, pa drejtësi, as drejtësi, pa falje”* (Mesazhi për Ditën e Paqes 2002). E më pas shtoi: *Mos lejoni që humbjet e jetëve e shkatërrimi që pësuar, t’i mbushin zemrat tuaja me helm e me mllëf. Kini guximin t’i bëni ballë çdo tundimi, që mund t’ju shtyjë drejt akteve të dhunës e të terrorizmit.*

E premte, 15 maj Tel-Aviv: lamtumira **Benedikti XVI:** erdha si mik i izraelitëve dhe i palestinezëve: kurrë më luftë! Kurrë më terrorizëm! Lutem për të ardhmen pa mure!

Në përfundim të udhëtimit të 12-të apostolik i Papës Benedikti XVI, pas tetë ditësh të ngjeshura me aktivitetet e takime në Tokën



Shenjte. *“Erdha në këtë vend si mik i izraelitëve dhe i palestinezëve”,* tha Papa në ceremoninë e lamtumirës, në aeroportin e Tel Avivit. Të pranishëm presidenti izraelit Shimon Peres dhe kryeministri Benxhamin Nétanjahu. E si mik, Ati i Shenjtë bëri këtë thirrje të fuqishme: *“Kurrë më gjakderdhje! Kurrë më ndeshje! Kurrë më terrorizëm! Kurrë më luftë! Tu thyejmë rrethin vicioz të dhunës. Të vendoset paqja e qëndrueshme, e bazuar mbi drejtësinë, qoftë pajtim e shërëm i vërtetë”.* Me tone të ndezura, fjalimi i fundit i Benediktit XVI në këtë shtegtim pas gjurmëve të Jezu Krishtit. Papa kërkoj që të njihet universalisht e drejta e Shtetit të Izraelit për paqe e siguri, brenda kufijve të njohura nga bashkësia ndërkombëtare dhe e drejta për një atdhe të pavarur palestinez, ku njerëzit të jetojnë me dinjitet e të mund të lëvizin lirisht. Zgjidhja e konfliktit në Lindjen e Mesme, që duhet të çojë në krijimin e dy shteteve, të mos mbetet ëndërr, por të bëhet realitet, theksoi Papa. Duke përshkuar etapat e udhëtimit, Ati i Shenjtë nuk e fshehu se një nga pamjet më të trishtuara, ishte muri i ndërtuar nga izraelitët për t’u mbrojtur nga palestinezët: *“Ndërsa ecja pranë tij, u luta për*

një të ardhme, në të cilën popujt e Tokës Shenjte të jetojnë së bashku në paqe e harmoni, pa nëvojën e mjeteve të tilla të sigurisë e të ndarjes, por duke e respektuar njëri-tjetrin, duke pasur besim tek tjetri, e duke begur dorë nga çdo formë dhunë dhe agresioni”. E di se arritja e këtij objekti do të jetë e vështirë, tha Papa duke iu drejtuar presidentit izraelit Peres e duke e siguruar atë dhe Autoritetin palestinez për luftën e veta e të katolikëve të mbarë botës. Benedikti XVI kujtoi edhe vizitën në Memorialin e Holokaustit Jad Vashem, ku u takua me të mbijetuarit e shfarosjes naziste: *“Ato takime thellësisht mallëngjyese ripërtërinë kujtimet e vizitës sime të tri vjetëve më parë në kampin e vdekjes së Ausvicit, ku kaq shumë hebrenj – nëna, baballarë, burra, gra, vëllezër, motra, miq – u shfarosën çnjerëzisht në një regjim pa Zot, që propagandonte ideologjinë e antisemitizmit dhe të urrejtjes. Ai kapitull i frikshëm i historisë – tha Papa – nuk dubet harruar apo mbuar kurrë. Në të kundërtën, ato kujtime të errëta dubet ta përforojnë vendosmërinë tonë e të na afrojnë edhe më tepër njërin me tjetrin, si degët e të njëjtit ulli, të ushgyer nga të njëjtat rrënjë e të bashkuar nga dashuria vëllazërore”.*



Imzot Rrok Mirdita rizgjidhet Presidenti i Konferencës Ipeshkëvore të Shqipërisë

Imzot Rrok Mirdita, Arqipeshkëvi Metropolit i Arkidieqzës Metropolitane në Tiranë - Durrës, u rizgjidh President i Konferencës Ipeshkëvore të Shqipërisë. Ai rizgjidhet për një mandat tjetër trevjeçar në këtë detyrë. Zv/president u zgjodh Imz. Angelo Massafra, Arqipeshkëvi Metropolit i Arkidieqzës Metropolitane Shkodër - Pult. Sekretar i Përgjithshëm u zgjodh Imz. Lucian Augustini ipeshkëvi i Dioqezës së Sapës. Konferenca Ipeshkëvore e Shqipërisë është e përbërë nga shtatë ipeshkëvinj. Hierarkia e Kishës Katolike në Shqipëri u ripërtëri nga Shenjtëria e Tij Papa Gjon Pali II më 25 prill të vitit 1993 në Shkodër ku shuguroj katër



ipeshkëvinj të parë pas rënies së komunizmit. Prej tyre vazhdon detyrën e Tij Imz. Rrok Mirdita në krye të Arkidieqzës Tiranë - Durrës.


Viti kushtuar Meshtarisë 19 qershor 2009 – 2010

Shën Gjon Maria Vianey

Në rastin e 150 vjetorit të vdekjes se Shën Gjon Maria Vianey, Shenjtëria e Tij ka shpallur se me 19 qershor behët hapja solemne e vitit kushtuar **“Vitet Meshtarak”** që do të ketë si temë: **“Besnikëri Krishtit, besnikëri meshtarise”**.

Ky vit hapet në solemnitetin e festes se Zemrës se Krishtit dhe do të përmbyllet me vitin

heqjen e përshpirtërisë se Shën Gjon Maria Vianey i cili ka qenë meshtarë në mesin e popullit të tij që e vizitonte, mësonte dhe e pajtonte, do të koordinohen shumë iniciativa pastorale, për t'i ndihmuar meshtarit të jet meshtarë në bashkësi, që të respektohet urdhri i meshtarisë në shoqëri dhe të vlerësohen nevojat e formimit të jetës meshtarake. E kujtojmë ndër të tjera që lettrat e Shën Palit dhe ajo drejtuar Hebrejve janë letrat që i ndihmojnë ripërtëritjes dhe vetëdijesimit të jetës pastorale – shpirtërore të meshtarit, edhe për ripërtëritje e reflektim shpirtërore gjatë vitit.



e ardhshëm pikërisht në sheshin e Shën Pjetrit me meshe të Kremtuar nga Papa dhe me meshtarë nga mbarë bota. Në porosinë e shpalljes se vitit meshtarak është përkujtuar edhe përgatitja e një Direktori për rrëfime dhe ushtrime shpirtërore për vitin kushtuar meshtarisë që i janë në shërbim meshtarit si një mundësi e ripërtëritjes së detyrave në shërbesë. Nën udhë-

viti Papa Benedikti XVI do të shpall Shën Gjon Maria Vianey **“Pajtor i meshtarëve të tërë botës”**. Përgatitjet i kanë filluar Kongregata e Klerit në Romë dhe gjitha Fakultetet Teologjike, Shtëpitë Rregulltare, Ordinaret e dioqezave dhe institutet rregulltare për të koordinuar aktivitetet të ndryshme për rolin e rëndësishëm të meshtarit në ungjillëzim dhe administrim të sakramenteve.

Shën Andreu

■ PËRGATITI:
Don Marjan Marku

Në numrin e kaluar kemi folur për Shën Pjetrin, ndërsa në këtë numër po vazhdojmë që t'i njohim edhe apostujt tjerë. Do të flasim për vëllanë e Shën Pjetrit, për Andrenë, i cili po ashtu ishte njëri prej të dymbëdhjetëve. Emri Andre nuk është një emër hebraik, por një emër grek dhe kjo nuk është një gjë e parëndësishme, sepse tregon një aspekt të gjerë të familjes. Ne gjendemi në Galile, ku kultura dhe gjuha greke ishte mjaft e pranishme. Në renditjen e apostujve, Andreu gjendet në vendin e dytë – tek Mateu (Mt 10, 1-4) edhe Luka (Lk 6, 13-16) – ndërsa tek Marku gjendet në vendin e katërt (Mk 3, 13-19) dhe në veprat e Apostujve dhe në bashkësinë e parë të krishterëve kishte një do me thënie shumë të rëndësishme (Vap 1,13-14).

Lidhshmëria e Pjetrit dhe Andreut si vëllezër, po ashtu edhe thirrja e tyre e përbashkët, shihet shumë qartë në Ungjill. Aty lexojmë: «Ndërsa po ecte bregut të Liqenit të Galileës, Jezusi pa dy vëllezër, Simonin që qubej Pje-

tër dhe Andreun, vëllanë e tij, që po hidhnin rrjetat në liqen. Ata ishin peskatarë. Jezui u tha: Ejani pas meje dhe unë do t'ju bëjë peskatarë njerëzish.» (Mt 4,18-19; vgl. Mk 1,16-17).

Nga Ungjilli i katër do ta marrim një detaj tjetër të rëndësishëm: Së pari Andreu ishte një nxënës i Shën Gjon Pagëzuesit, dhe aty e shohim se ishte një njeri, i cili e kërkonte Hyjin, një njeri që e ndante shpresën e Izraelit dhe se dëshironte ta njihnte sa më mirë fjalën hyjnore. Ai me të vërtetë ishte një njeri i fesë dhe i shpresës dhe një ditë e dëgjoji Shën Gjonin duke e quajtur Jezusin «qengji i Hyjit» (Gjn 1, 36); dhe me një nxënës tjetër u ngut për ta parë atë njeri të cilin Shën Gjonin e quajti «qengji i Hyjit». Ungjilltari na lajmëron për këtë rast: Ata «e panë se ku banonte dhe atë ditë qëndruan me të» (Gjn 1, 37-39). Andreu përjetonte takime të rëndësishme me Jezusin. Tregimi vazhdon tutje me një lajmërim të rëndësishëm: «Andreu, vëllai i Simonit Pjetrit, ishte njëri prej atyre të dyve që ndoqën Jezusin, pasi dëgjuan fjalë të Gjonit. Ai takoi të parin vëllanë e vet, Simonin, dhe i tha: Gjetëm Mesinë, domethënë të shuguruarin

(Krishtin). Ai e çoi atë te Jezusi» (Gjn 1, 40-42) edhe dëshmoi një shpirt të jashtëzakonshëm apostolik. Andreu ishte apostulli i parë, i cili ishte i thirrur për të shkruar pas Jezusit. Për këtë arsye liturgjia e Kishës bizantine e quan atë me emrin «Protoklitos», që do me thënë i thirruri i parë. Dhe me siguri për shkak të lidhshmërisë së tyre vëllazërore në mes Pjetrit dhe Andreut, dy kishat, ajo e Romës edhe ajo e Konstantinopojës, në mënyrë të posaçme janë sy dy kisha motra.

Ungjilli përmend emrin e Shën Andreut në mënyrë të posaçme edhe në tri vende të rëndësishme. Vendi i parë ishte shumëzimi i bukëve në Galile. Në atë gjendje të vështirë, Andreu ishte ai i cili e njoftoi Jezusin për një djalosh të ri, i cili kishte pesë bukë elbi dhe dy peshq; shumë pakë bukë dhe peshq – mendoi ai – për aq shumë njerëz (ishin pesë mijë burra) të cilët ishin të mbledhur në atë vend (krah. Gj. 6, 8-9). Ai e pa djaloshin e ri – ai kishte thënë kështu: «por fjalë janë këto për aq njerëz!» (ebd.) – dhe vërejt, se ato nuk do të mjaftojnë për gjithë atë popull.

Ngjarjen e dytë e kemi Jerusalemin. Nxënësit së bashku me Jezusin ishin duke dalë nga Tempulli dhe njëri prej nxënësve i tha Jezusit: Mësues, shiko çfarë gurësh të mëdhenj, të cilët e bartin tempullin. Përgjigja e mësuesit ishte e befasishme: Ai tha, A po i sheh këto godina madhështore? Nuk do të mbesë as gur mbi gurë pa u rrëzuar!

Pastaj e pyetën Andreu së bashku Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin: «Na trego kur do të ndodhin këto dhe cila do të jetë shenja se të gjitha këto do të vërtetohen?» (Mk 13, 1-4). Si përgjigje në këtë pyetje Jezui ju mbajti një fjalim të rëndësishëm mbi rrënimin e Jerusalemit dhe mbi fundin e botës dhe i ftoi apostujt që t'i njohin dhe t'i lexojnë shenjat e kohës dhe që të jenë përherë të zgjuar. Nga ky takim mund të mësojmë se kurrë nuk guxojmë që të kemi frikë për ta pyetur Jezusin, por edhe që të jemi të gatshëm që mësimin, të cilin na jep që ta marrim edhe nëse është e papritur dhe nganjëherë e rënde.

Në Ungjill kemi edhe një iniciativë të tretë mbi Andreun. Vendi i ndodhjes përsëri

është Jerusalemi, shkurt para mundimit të Jezu Krishtit. Për festën e Pashkëve – siç na informon Gjonin – ishin edhe disa grekë, sipas gjitha gjasave disa Proselitë, apo disa njerëz që u adhuronin Hyjin, të cilët kishin ardhur në qytetin e shenjtë, për t'u lutur Hyjit të Izraelit për festën e Pashkëve. Andreu dhe Fili-



pi, të dy apostuj me emra grekë, kryenin rolin e përkthyesve dhe ndërmjetësuesve të këtij grupi të vogël tek Jezusi. Përgjigja e Zotit në pyetjen e tyre sipas Gjonit ishte e pakapshme, por në anën tjetër shumë domethënëse. Jezusi iu tha të dy nxënësve, por dhe botës greke:

«Arriti ora të lavdërohet Biri i njeriut. Përmend, përmend po ju them: nëse kokrra e grurit e mbjellë në dhe nuk vdes, mbetet e vetme; por nëse vdes jep shumë fryt!» (Gjn 12, 23-24). Çfarë domethënie kanë këto fjalë në këtë kontekst? Jezusi dëshiron të thotë: Po, takimi në mes meje dhe grekëve do të ndodhë, por jo si një bisedë e shkurtë në mes meje edhe disa njerëzve. Me vdekjen time, e cila krahasohet me kokrrën e grurit të mbjellë në dhe, do të vijë koha e lavdërimit tim. Nga vdekja ime në kryq do të sjellë frytë të shumta: «kokrra e vdekur» – Simbol për të kryqëzuarin – me ringjallje do të jetë buka e jetës për mbar botën, do të jetë dritë për popuj dhe kultura. Po, takimi me shpirtin grek, me botën greke, realizohet në atë thellësi në shembullin e kokrrës së grurit, i cili thith fuqinë e tokës dhe të diellit për t'u bërë bukë.

Me fjalë të tjera, Jezusi profetizon Kishën e grekëve, kishën e gjithë botës, frytin e Pashkëve të tij.

Tradita shumë e vjetër e tregon Andreun, i cili këto fjalë të Jezusit ua ka ndërmjetësuar gre-

këve, jo si përkthyes por si dëshmitarë i Jezusit dhe për atë arsye edhe quhet apostull i grekëve.

Pjetri, vëllai i tij, arriti prej Jerusalemit nëpër Antiokinë në Romë për ta realizuar dërgimin e tij universal, ndërsa Andreu ishte apostull i botës greke: Dhe kështu tregohen si në jetë po ashtu edhe në vdekje si vëllezër të vërtetë dhe kjo shihet edhe sot në lidhshmëri në mes dy kishave, në mes Romës dhe Konstantinopojës. Një lajmërim më i vonshëm na lajmëron se Andreu është kryqëzuar në Patras. Pra sikurse edhe vëllai i tij Pjetri, edhe Andreu vdiq në kryq për mësuesin e tij, për Jezu Krishtin. Në rastin e tij kemi një kryq të formës X, që ka pamjen e dy drynave diagonal dhe kështu quhet si kryqi i Shën Andreut. Një lajmërim nga koha antike nga fillimi i shekullit të 6, me titull Mundimi i Andreut, tregon se Andreu apostull ka thënë: «Të falem o kryq, i shuguruar me trupin e Krishtit dhe i zbukuruar nga gjymtyrët e tija me perla të çmueshme.

Kryqi ynë do ta ketë kuptimin e plotë, nëse e shikojmë si një pjesë të kryqit të Krishtit dhe nëse atë e pranojmë. Në këtë kryq janë të pranishme edhe vuajtje e tona, por së bashku me Jezusin e fitojnë edhe kuptimin e plotë.

Andreu Apostull le të na mësojë që të shikojmë pas Jezusit, duke i takuar njerëzit, që të flasim me njerëz për Jezusin, që të bëhemi dëshmitarë e tij kudo të gjendemi.



Veprimi i Shpirtit Shenjt në jetën dhe në misionin e Kishës

"Por, ju o të dashur, ndërtojeni veten mbi themelin e fesë suaj tejet të shenjtë duke u lutur në Shpirtin Shenjt. Qëndroni në dashurinë e Hyjit duke pritur mëshirën e Zotit tonë Jezu Krishtit për jetën e pasosur" (Jud 1, 20-21).

■ SHKRUAN:
Don Anton Ukaj

Në tekstet e Besëlidhje së Re gjejmë të paraqitura dy misione shumë të mëdha dhe të rëndësishme, të cilat shkaktojnë lindjen e një populli të ri – Kishës.

Misioni i parë dhe shumë i rëndësishëm ndërlidhet me figurën e Birit të Zotit: Jezu Krishtit, të mishëruar nga dashuria për të shpëtuar dhe shëlbuar mbarë njerëzimin (Gjn 6, 44). Dhe misioni i dytë gjithashtu i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm ndërlidhet me veten e tretë Hyjnore: Shpirtin Shenjt, të dërguar nga Ati në emër të Birit për të përforcuar dhe drejtuar Kishën në misionin e shenjtë drejtë shëlbimit (Gjn 14, 26).

Edhe Papa Benedikti i XVI në magjisterin e tij mbi Shpirtin Shenjt dhe mbi lindjen e Kishës thotë kështu: *"Me Rrëshajat, Kisha themelohet jo nga vullneti njerëzor, por nga forca e Shpirtit të Zotit. E menjëherë duket se si ky Shpirt i jep jetë një bashkësie, që është njëkohësisht një e universale, duke kapërcyer mallkimin e Kullës së Babelit. Në fakt, vetëm Shpirti Shenjt, që krijon bashkim në dashuri e në pranimin e ndërsjellët të ndryshimeve, mund ta çlirojë njerëzimin nga tundimi i vazhdueshëm i pushtetit tokësor, që dëshiron të dominojë e të uniformojë gjithçka"*.

Misioni i dyfishtë, i Birit dhe i Shpirtit Shenjt, bën të lindë një bashkësi e re, së cilës i mundësohet hyrja dhe lidhja e re me jetën Hyjnore përmes Trinisë shenjte. Nga kjo kuptohet qartë se Shpirti Shenjt, së bashku me Fjalën e mishëruar, bëjnë që të lindë populli i shenjtë i Zotit: Kisha.

Të flasësh apo të shkruash për themelin e bashkësisë së krishterë – Kishës, e të mos flasësh për rolin dhe veprimin e Shpirtit Shenjt në krijimin e kësaj bashkësie, pothuajse është e pamundshme.

Para se të shpjegojmë më gjerësisht rolin e pamohueshëm të Shpirtit Shenjt në lindjen, rritjen dhe ruajtjen e Kishës, është mirë që të jepet një definicion mbi Shpirtin Shenjt.

Kush është Shpirti Shenjt?

Shpirti Shenjt është veta e tretë hyjnore e së shejtnushmes

Trini. Shpirti Shenjt është Zot, është një person jo me fytyrë të dukshme. Jezusi Shpirtin Shenjt e krahason me frymën: *"Era frynë në drejtim që do; ia dëgjon ushtrimen e nuk di nga vjen e kab shkon"* (Gjn 3, 8). Shpirti është fryma që flet. Sikurse fryma ashtu edhe simbolet e tjera të Shpirtit: uji, zjarri, ajri, fryma... nuk sjellin as një figurë (fytyrë), por paraqesin apo paraqytyrojnë një prani të gjithmbarshme. Shpirti i Zotit është fuqi dhe dashuri gjithëpërfshirëse. Shpirti i Zotit është fryma e vullshme që frynte mbi ujërat në ditën e parë të krijimit; është fryma që zbriti mbi virgjëren Mari në ditën e parë të shëlbimit: *"Shpirti Shenjt do të zbrës në ty e fuqia e Hyjit të tejetlartë do të të mbulojë me bijen e vetë"* (Lk 1, 35).

Shpirti i Zotit është fuqi dashurie, sepse vetë Zoti është dashuri. Në librin e Veprave të Apostujve lexojmë kështu: *"Hyji Jezusin prej Nazaretit e shuguroi me Shpirtin Shenjt e me pushtet; Atë që e përshkoi vendin duke bërë mirë e duke shëruar të gjithë ata që kishin rënë nën pushtetin e djallit, sepse Hyji ishte me Të"* (Vap 10, 38).

Jezusi e komunikoi këtë fuqi dashurie pandërprerë dhe pa pushuar të gjithë popullit: *"Do ta kini fuqinë e Shpirtit Shenjt"* (Vap 1, 8). Dhe Shpirti do të prodhojë në të gjithë një vërshim karizmatik dhe do të krijojë zemra besimtare në Zotin dhe të dashura ndaj të tjerëve.

Kështu lexojmë në librin e Izaisë profet: *"Unë do t'ju japë një zemër të re, një shpirt të ri do ta fus në ju, do ta nxjerrë nga misbi juaj zemrën e gurtë e do t'ju japë një zemër misbi. Shpirtin tim do ta fus në ju e do të bëjë që të ecni urdhërimeve të mia e t'i zbatoni e t'i vini në veprim gjyqet e mia"* (Ez 36, 26-28). Ky ishte premtimi i Atit që realizohet saktësisht ditën e Rrëshajave.

Ja çka shkruajnë Veprat e Apostujve: *"Kur erdhi dita e Rrëshajave, të gjithë ishin së bashku në të njëjtin vend. Dhe, ja, papritmas, u ndie një ushtrim nga qielli si shungullimë e erës së fortë dhe e mbushi të gjithë shtëpinë, ku ata ishin. Atyre atëherë iu dukën gjuhë, si të ishin prej zjarri. Këto u ndanë e zunë vend një nga një mbi secilin prej tyre. Të gjithë u mbushën me Shpirtin Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë të ndryshme, ashtu si Shpirti Shenjt i shndriste të shpre-*



“Me Rrëshajat, Kisha themelohet jo nga vullneti njerëzor, por nga forca e Shpirtit të Zotit. E menjëherë duket se si ky Shpirt i jep jetë një bashkësie, që është njëkohësisht një e universale, duke kapërcyer mallkimin e Kullës së Babelit. Në fakt, vetëm Shpirti Shenjt, që krijon bashkim në dashuri e në pranimin e ndërsjellët të ndryshimeve, mund ta çlirojë njerëzimin nga tundimi i vazhdueshëm i pushtetit tokësor, që dëshiron të dominojë e të uniformojë gjithçka. (Papa Benedikti i XVI)”

beshin" (Vap 2, 1-4).

Shpirti Shenjt, i cili është dashuri, bashkon njerëzit në diversitetin e tyre, në ndryshueshmërinë e gjuhëve, e kulturave dhe të vendeve. Kisha është universale, katolike – e gjithmbarshme: në të, çdo kombësi është sikurse në shtëpinë e vetë dhe e dëgjon gjuhën e vetë. Fuqia e Shpirtit Shenjt i bën të krishterët dëshmitarë të bindur dhe të sigurt. Këtë e kishte thënë edhe Jezusi: *"Nuk do të jeni ju që do të flisni, por Shpirti i Atit tuaj do të flasë nëpërmjet jush"* (Mt 10, 20); *"E Shpirti Shenjt – Mbrojtës do t'ju mësojë të gjitha dhe do t'ju përkujtojë gjithçka unë ju thashë"* (Gjn 14, 26).

Shpirti Shenjt është premtimi i Atit dhe i Birit, dhuratë e Atit

dhe e Birit. Jezusi kishte thënë: *"Edhe unë do t'i lutem Atit dhe Ai do t'ju japë një Mbrojtës tjetër, që të jetë me ju përgjithmonë: Shpirti i së Vërtetës, që bota s'mund ta marrë, sepse nuk e sheh as nuk e njeh. Ju e njihni sepse Ai banon me ju e është në ju"* (Gjn 14, 16-17).

Shpirti Shenjt, fuqi dhe hir në shpalljen e Ungjillit

Shpallja e Lajmit të gëzueshëm, kthimi në jetën e re përmes pagëzimit në emër të Atit, të Birit dhe të Shpirtit Shenjt, mishërimi i Fjalës së Zotit në mendjen dhe zemrën e njerëzve, padyshim se janë meritë e veprimit të Shpirtit Shenjt i cili vepron përmes jetës dhe veprës së njerëzve.

Tekst shumë i rëndësishëm, i cili prezanton përmbajtjen e shpalljes së Lajmit të gëzueshëm dhe misionin angazhues të shpallësve të këtij Lajmi është libri i Veprave të Apostujve. Në kapitullin e pestë gjejmë të shkruar kështu: *"Jezu Krishti është ai, që Hyji me të djathtën e vet e lartësoi dhe e bëri Prijës e Shëlbues për t'i dëbuar Izraelit hirin e kthimit e faljen e mëkateve. Për këto ngjarje jemi dëshmitarë ne dhe Shpirti Shenjt, të cilin ua dha Hyji atyre që i nënshtrohen"* (Vap 5, 31-32).

Ky është thelbi i porosisë së krishterë: Jezu Krishti, i vdekur dhe i ringjallur, është lartësuar si Prijës i shpëtimin tonë. Bartës dhe shpallës të kësaj të vërtete, as një herë të dëgjuar më parë,

janë apostujt dhe Shpirti Shenjt. Dëshmisë së Apostujve u bashkëngjitet dëshmia e Shpirtit Shenjt. Dhe kjo mund të vërtetohet më së miri nga guximi, veprimi, besimi dhe vullneti tejte i madh i apostujve në kryerjen e këtij misioni ungjillëzues.

Shpirti Shenjt është Ai, i cili sugjeronte krye-apostullin Pjetrin dhe të gjithë nxënësit e tjerë të shkonin e të predikonin edhe ndër paganë dhe t'i pranonin ata si amtarë të rinj të bashkësisë së krishterë edhe pa ritin e rreth-prerjes.

Shpirti Shenjt shtyri apostujt dhe të gjithë nxënësit e tjerë të shkonin në të katër anët e botës për ta shpallur Jezu Krishtin e kryqëzuar, të vdekur dhe të tretën ditë të ringjallur. Shpirti Shenjt ruante dhe caktonte njerëz që më parë përndjeknin dhe mohonin të vërtetën mbi Birin e Zotit: "Shpirti Shenjt tha: m'i ndani Barnabën e Saulin të kryeqin veprimtarinë për të cilën i kam thirrur" (Vap 13, 2). Shpirti Shenjt mësonte dhe qortonte ata të cilët i kishte vërë si prijës të grigjës së Zotit: "Kini kujdes për vetë e për grigjën, mbi të cilën Shpirti Shenjt ju çoi mbi këmbëqyrës. Udhëbëgimi Kishën e Hyjit, që me gjakun e vet e fitoi për vetë" (Vap 20, 28).

Me pak fjalë mund të thuhet se Shpirti Shenjt është protagonist i parë i shpalljes së Ungjillit të Krishtit, Shpirti Shenjt e bëri dhe vazhdon ta bëjë edhe sot e kësaj dite misionare Kishën e Krishtit.

Edhe Shën Pali, apostulli i popujve, provon dhe dëshmon se Lajmi i Gëzueshëm shpallet dhe dëshmohej "jo vetëm me anë të fjalës, por edhe i përcjellë me fuqi dhe me Shpirtin Shenjt" (1 Sel 1, 5).

Shën Pali Shpirtin Shenjt ia rezervon një rol të veçantë në jetën e besimtarëve. Të pagëzuarit e jetojnë jetën e krishterë përmes veprimit apo nën ndikimin e Shpirtit Shenjt: "Ju nuk jeni nën ndikimin e mishit, por nën atë të Shpirtit Shenjt, në qoftë se Shpirti i Hyjit banon në ju. Nëse ndokush nuk e ka Shpirtin e Krishtit, ai nuk i përket Atij. E nëse Krishti është në ju, trupit është patjetër i vdekur për shkak të mekatit e Shpirti është jetë për shkak të drejtësisë" (Rom 8, 9-11).

Kështu që Shpirti Shenjt, i cili vjen përmes Atit dhe Birit e që banon në ne, përcjell me një efikasitet të madh jetën tonë të krishterë gjatë tërë ekzistencës, nga ngjizja e deri në ringjalljen e fundit. Shpirti i Zotit është ai i cili ndihmon të jetohej në përputhshmëri me jetën e re, e cila vjen prej Zotit përmes Jezu Krishtit.

Zemra e kësaj jete të re hyjnore, e cila është në brendësinë tonë, aktualizohet dhe ushtrohet përmes veprimit të Shpirtit Shenjt. Shën Pali thotë: "Bijtë e Hyjit janë ata, të cilët i udhëbëg Shpirti i Hyjit" (Rom 8, 14). Dhe vazhdon duke thënë: "Ju veç nuk e keni marrë Shpirtin që bën robër në mënyrë që përsëri të trembeni, por keni marrë Shpirtin që ju bën

bij të adoptimit, në saje të të cilit ne thërrasim: Abba! O Atë! Vetë Shpirti Shenjt dëshmon bashkë me Shpirtin tonë se jemi fëmijët e Hyjit" (Rom 8, 15-16).

Dinjteti ynë shpirtëror qëndron pikërisht në atë se jemi bijtë e Hyjit, në sa marrim pjesë në bijësinë e Birit të Hyjit që është Jezu Krishti.

Pali thërret bashkësinë e Korintit, e cila jetonte e entuziazmuar përtej mase nga predikuesit e tyre, duke ua bërë me dije rrezikun e madh që i kanosej porosisë ungjillorë duke rrezikuar që ajo të shndërrohej në një mësim filozofik: "Po ju a nuk e dini se jemi Tempulli i Hyjit dhe se Shpirti i Hyjit banon në ju? Nëse ndokush e rrënon Tempullin e Hyjit, Hyji do ta humbasë atë, sepse Tempulli i Hyjit është i shenjtë - e ky Tempulli jeni ju! Askush mos ta gënjejë vetveten! Në qoftë se ndokush prej jush kujton se është i mençur sipas parimeve të shekullit, le të bëhet i marrë për të qenë i urtë. Sepse dija e kësaj bote është marri para Hyjit, sepse Shkrimi i shenjtë thotë: Ai i zë të dijsmëit në dredhitë e tyre. Dhe përsëri: "Zoti i njëjti mendimet e të mençurve, e di se janë të kotat" (1 Kor 3, 16-20). Nga kjo kuptojmë se bashkësia e krishterë apo Kisha karakterizohet nga prania e Shpirtit Shenjt në të, dhe kjo duhet të vlejë edhe për jetën e secilit të krishterë.

Shën Pali gjithashtu dëshiron të thekson se Shpirti Shenjt vepron në Kishë, përmes Kishës dhe për të mirën e Kishës. Pali e krahason bashkimin e të krishterëve me atë të gjymtyrëve në një trup të vetëm: "Dhe njëmend, sikurse një trup i vetëm ka shumë gjymtyrë e të gjitha gjymtyrët e trupit, edhe pse shumë - nuk trajtojnë veçe një trup të vetëm - ashtu edhe Krishti. Vërtet, në një të vetmin Shpirt Shenjt të gjithë jemi pagëzuar për të qenë një trup i vetëm, si hebrejtë - ashtu grekët, si robërit ashtu edhe të lirët dhe të gjithë e kemi shuar etjen në të njëjtin Shpirt Shenjt" (1 Kor 12, 12-13).

Shpirti Shenjt në jetën e besimtarëve përmes sakramenteve

Shpirti Shenjt përveç se të jetë zemra e Kishës, Ai është edhe zemra e secilit besimtar nga momenti i hyrjes së tij në Kishë përmes sakramentit të pagëzimit.

Në mënyrë krejt personale bëhemi amtarë të Kishës, apo gjymtyrë të trupit mistik të Krishtit, me sakramentin e shenjt të pagëzimit, si dhe rritimi dhe forcimi në të me sakramentet e tjera dhe me hirin shëlbimprues që ato sjellin. Hyrja, rritja dhe përfortimi në bashkësinë e popullit të Zotit bëhet gjithmonë nën ndikimin e Shpirtit Shenjt.

Shën Pali në letrat e tij lë të kuptohet se Zoti e ka shpëtuar njerëzimin për mëshirën e vet përmes larjes rilindëse të pagëzimit dhe përmes ripërtëritjes së Shpirtit Shenjt, të zbrazur mbi ne përmes Jezu Krishtit Zot dhe shpëtimtar.

"Kur apostujt dëgjuan në Jerusaleem se Samaria e kishte pranuar Fjalën e Hyjit i dërguan atje Pjetrin e Gjonin. Këta zbritën atje, u lutën për ta që ta merrnin Shpirtin Shenjt, sepse ende nuk kishte zbritur mbi asnjërin ndër ta; ata vetëm ishin pagëzuar në Emër të Jezusit Zot. Atëherë vunë duart mbi ta dhe ata morën Shpirtin Shenjt." (Vap 14, 17). Nga këta rreshta të Veprave të Apostujve hasim një moment tjetër shumë të rëndësishëm të takimit mes Shpirtit Shenjt dhe individit, që ne në Kishë e quajmë sakramenti i krezmimit apo i përfortimit.

Përveç këtyre dy sakramenteve, pagëzimit dhe krezmimit, ku prania dhe veprimi i Shpirtit Shenjt është dukshëm i theksueshëm, Pali edhe Eukaristinë apo Kungimin shenjt e quan "ushqim dhe pije shpirtërore" (1 Kor 10, 3-4). Në fakt Jezu Krishti, në bukën dhe në verën e shuguruar, dhurohet si shpirt gjallëruës për jetën e besimtarit.

Shpirti Shenjt i Zotit, dhurohet përmes Jezu Krishtit të ringjallur edhe përmes faljes së mëkateve, arrin me një efikasitet të jashtëzakonshëm në jetën e besimtarit kur ai ju afrohet me një devotshmëri dhe besim sakramentit të rëfimit (Gjn 20, 22).

Veprimin e Shpirtit Shenjt në jetën dhe në misionin e Kishës e gjejmë të pranishëm edhe në lutjen dhe në uratën e të zgjedhurëve të Zotit. Në pjesën e fundit të letrës së Judës gjejmë të shkruar kështu: "Por, ju o të dashur, ndërtojeni veten mbi themelin e fesë suaj tejet të shenjtë duke u lutur në Shpirtin Shenjt. Qëndroni në dashurinë e Hyjit duke pritur mëshirën e Zotit tonë Jezu Krishtit për jetën e pasosur" (Jud 1, 20-21). Në këtë tekst të mrekullueshëm trinitar, Shpirti Shenjt i Zotit, i cekur më së pari, qëndron në lidhje të ngushtë me uratën, kurse Zoti me dashurinë dhe Jezu Krishti me mëshirën.

Shën Pali fton besimtarët që të mbushen me Shpirtin Shenjt me himne, lutje dhe këngë: "Mbushuni me Shpirtin Shenjt. Thoni së bashku psalme, himne e këngë të përsëritshme! Këndoni e lavdëroni Zotin në zemrat tuaja! Gjithmonë dhe për çdo gjë falënderoni Hyjin Atë në emër të Zotërisë tonë Jezu Krishtit" (Ef 5, 18-20). Shpirti i Zotit është ai që nxit dhe i jep vlerë uratës sonë të shumëtrajtshme që, përmes Jezu Krishtit arrin te Ati.

Dhe në fund duhet të thuhet edhe diçka në lidhje me dhuratat apo karizmat, që duke filluar nga Koncili II i Vatikanit, kanë filluar në mënyrë krejt të veçantë të bëhen pjesë e teologjisë. Fjalën greke karizmë e takojmë shumë herë në letrat e Shën Palit dhe ka domethënie të ndryshme.

Fjala karizmë (charisma) ka prejardhjen nga fjala 'charizomai' dhe dëshiron të shprehë atë që është bujar, që dhuron diçka... dhe ka nëndërlidhje të ngushtë me fjalën 'charis' që do të thotë hiri.

Tekstet e shumta biblike flasin për diversitetin dhe për unitetin



“Shpirti Shenjt është protagonist i parë i shpalljes së Ungjillit të Krishtit, Shpirti Shenjt e bëri dhe vazhdon ta bëjë edhe sot e kësaj dite misionare Kishën e Krishtit.”

e karizmave dhe të lidhjes së tyre me hirin e Shpirtit Shenjt: "Dhuratat janë të ndryshme, por Shpirti Shenjt është i njëjtë, edhe shërbesat në përhapje të Ungjillit janë të ndryshme, por Zoti është i njëjtë, po edhe mënyrat e veprimit janë të ndryshme, por Hyji është i njëjtë. Ai bën gjithçka në të gjithë. Secili merr dhuratë të veçantë të zbulesës së Shpirtit Shenjt për të mirën e përbashkët. Dhe njëmend, Shpirti Shenjt i jep njeri fjalën e urtisë, kurse i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fjalën e dijes; po i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fenë, një tjetri prapë, i njëjti Shpirt Shenjt, i jep dhuratën e shërimeve; një tjetri pushtetin për të bërë mrekulli, një tjetri profecinë, një tjetri aftësinë të dallojë shpirtërat, një tjetri zotësinë e gjubëve të ndryshme, një tjetri shtjellimin e gjubëve. E të gjitha këto i bën një i vetmi Shpirt Shenjt duke i ndarë veçanërisht secilit ashtu si Ai do" (1 Kor 12, 4-11).

Shpërndarës i karizmave apo dhuratave është Shpirti Shenjt, i cili ua ndan ato njerëzve sipas dëshirës së vet dhe njerëzit janë të ftuar t'i përdorin ato për të mirën e njëri-tjetrit: "Shërbejini njëri-tjetrit, secili sipas dhuratës që keni marrë: si mbarështues të mirë të hirit të shumëllojshëm të Hyjit" (1 Pjt 4, 10).

Edhe në mësimin e Kishës, i cili si bazë ka Fjalën e Zotit, thuhet se Shpirti Shenjt me dhuratat e veta i përgatit njerëzit duke i dalë përpara me hirit e veta në mënyrë që t'i drejtojë drejt Krishtit; ua tregojnë atyre Krishtin e Ringjallur, hap mendjen dhe zemrën e tyre për të kuptuar vdekjen dhe ringjalljen e Tij, ua kujton atyre Fjalën e vet, e hap shpirtin e atyre që e lexojnë dhe e dëgjojnë me dashuri dhe me sy të fesë, ua mundëson të gjithëve të jetojnë dhe të veprojnë sipas urdhrave të Tij të dashurisë ndaj Zotit dhe ndaj vëlait njeri.

In memoriam!

Mons. Milorad Defar

(Bosanski Brod, 02 shkurt 1924 – Podgoricë, 26 mars 2009)



■ PËRGATITI:
Don Albert JAKA

Nëse për ndonjë njeri mund të thuhet atëherë me siguri edhe për Don Milën, fjalët e Shën Palit: "Luftën e mirë e luftova, urapimin e krevës, fenë e ruajta." (2 Tim 4, 7).

Me 26 mars, në Podgoricë, në moshën 85 vjeçare, ndërroi jetë meshtari kroat Don Milorad Defar. Në familje quhej "Milo", ndërsa "Don Mila" quhej nga besimtarët katolikë shqiptarë. Meshtar i Ipeshkvisë së Prizrenit, ndërsa përfundimisht në pension del me dekret të Ordinariatit Arqipeshkvor të Tivarit, me 18 janar 1997.

Don Mila, tërë jetën e tij meshtarake e kaloi në popullin shqiptar. Në shkrimet e tij e ka përshkruar veten si "kroat i shqiptarizuar".

Të dhëna biografike

Don Miloradi, lindi me 02 shkurt 1924 në Bosanski Brod nga prindërit Anton e Maria Defar, ku prindërit e tij kishin ardhur nga Istria (Kroaci). Pagëzohet me 17 shkurt 1924 në Kishën e Shën Elisë Profet në Bosanski Brod. Katër klasat e para (1930-1934) i kreu të Murgeshat e Shën Kryqit, në Bosanski Brod, ndërsa Gjymnazin shtetëror (1935-1944), në Slavoniki Brod. Studimet filozofike e teologjike (në vitet

1945-1951) i fillon dhe mbaron në Zagreb.

Shugurimi Meshtarak bëhet me 02 korrik 1950, në Katedralen e Zemrës së Krishtit në Shkup, prej duarve të Ipeshkvit të atë-hershëm Mons. Smiljan Franjo Čekada, *Ipeshkëvi i Shkupit* dhe *Administrator Apostolik i Banja Lukës*.

Veprimtaria pastorale

Don Mila, sapo shugurohet, zëvendëson përkohësisht në famullinë e Mitrovicës (nga 08 tetor 1951 deri 10 shtator 1952). Ndërkohë kryen edhe shërbimin ushtarak në Prilep (Maqedoni).

Me dekret të Ordinariat emërohet kapelan i Don Marjan Gllasnoviç-Shala në Gjakovë (nga 28 nëntor 1952), njëkohësisht ishte edhe kujdestar i Shenjtërores së Shën Antonit në Gjakovë. Po ashtu zëvendëson famullitarin e Novo Sellës, për arsye në atë kohë Don Nikollë Mini, ishte në shërbimin ushtarak.

Me dekret të Ordinariat emërohet administrator i famullisë së Gucisë (nga 24 tetor 1953 deri 13 tetor 1961), fshat nën Bjeshkët e Nëmuna. Ndërton Shtëpinë e parë famullitare në Guci (Mali i Zi) me 1957. Për arsye se mbante Mësim Feje nëpër shtëpia e burgosin: për 2 muaj në vitin 1956, 15 ditë në 1958, 15 ditë në 1959. Famullia e Gucisë në atë kohë numëronte rreth 1800 besimtarë, duke pasur parasysh se kishte shumë familje te emigruara nga

Shqipëria. Familjet edhe pse jetonin nëpër male dhe në një varfëri të skajshme, megjithatë feja e tyre në Krishtin ishte e thellë.

Emërohet administrator i famullisë ("administratorom in spiritualibus") i Bishtazhinit (atëherë Smaq), që nga 13 tetor 1961 deri 04 dhjetor 1964. Prej 1964 deri 1966 është famullitar në Zym. Përsëri kthehet në Bishtazhin, prej vitit 1966 deri 15 prill 1987. Ai qendër në famullisë nga Smaqi e kaloi në Bishtazhin. Sepse Kisha e vjetër dhe selia famullitare në Smaq ishte larg besimtarëve, ndërsa Bishtazhini ishte pothuajse në qendër të fshatrave përreth. Brenda kësaj kohe ai fillon me ndërtimin e Kishës madhështore, në nder të Zojës Rruzare. Bekimi i gurtë-melit bëhet me 18 korrik 1968. Në kohën kur është ndërtuar kisha e Bishtazhinit, sistemi komunist ishte në lulëzim dhe jo vetëm që nuk lejonin ndërtimin e kishës, por me çdo kusht pengonin edhe aktivitetet e Kishës Katolike. Për leje kërkoheshin të paktën tre projekte të ndryshme. Komuna dha leje vetëm për projektin më të vështirë, për të cilin mendonin se realizimi i tij do të jetë i pamundshëm në rrethanat e asaj kohe. Por Don Mila, me ndihmën e Zotit dhe të bamirësve, ka arritur të ndërtojë atë Kishë, e cila është një ndër kishat më të bukura që kemi në Dioqezën e Kosovës, me të drejtë Mons. Nikë Prela këtë Kishë e quante "Miss-i i Kosovës".

“Don Mila, ka udhëtuar me kal, biçikletë, motor, dikur edhe me makinë. Edhe pse me origjinë kroat, por me zemër shqiptar. Ishte figurë e jashtëzakonshme e një meshtari të thjeshtë, të durueshëm, plotë dashuri e mirësi ndaj çdo personi, krejtësisht i përkushtuar për Kishën e Zotin. Ishte bekim i dioqezes sonë”

Gjatë kësaj kohe, ka kryer edhe këto detyra në nivelin dioqezan: anëtar i Gjyqit kishtar (1970), Dekan i Dukagjinit (3 vite), konsultor-këshilltar (6 vite). Nga Bishtazhini, me vite ka shërbyer edhe famullinë e Gucisë.

Prej vitit 1988 deri 1990, shërbeu si misionar për shqiptarët në Kroaci (Zagreb). Me 13 tetor 1990 ka një fatkeqësi me makinë në komunikacion, në Deçan. Me 17 mars 1991 fillon të kremtoi Meshën Shenjte për besimtarët tanë në Gjuhën shqipe në Kishën e Shën Rrokut, në Zagreb.

Që nga viti 1993, Don Mila shërben në Shqipëri (Shkrel, Bogë, Reç...). Ndërsa me dekret të Imzot Zef Gashit, Arqipeshkëvi i Tivarit me 18 janar 1997,





Kisha e Zojës Rruzare në Bistazhin

“ Don Miloradi (populli ynë e quante shkurtimisht “Don Mila”) tregon që kisha e vjetër dhe selia famullitare në Smaq ishte larg besimtarëve, ndërsa Bishtazhini ishte pothuajse ne qendër të fshatrave përreth. Në kohën kur është ndërtuar kisha e Bishtazhinit, sistemi komunist ishte në lulëzim dhe jo vetëm që nuk lejonin ndërtimin e kishës, por me çdo kusht pengonin edhe aktivitetet e Kishës Katolike. Për leje kërkoheshin të paktën tre projekte të ndryshme. Komuna dha leje vetëm për projektin më të vështirë, për të cilin mendonin se realizimi i tij do të jetë i pamundshëm në rrethanat e asaj kohe. Por Don Miloradi, me ndihmën e Zotit dhe të bamirësve, ka arritur ta ndërtojë atë Kishë, e cila është një ndër kishat më të bukura që kemi në Dioqezën e Kosovës. **“**

emërohet Famullitar i Nikshiqit dhe Rrëfyes i Motrave Françeskanë të Zojës së Papërlyer.

Me vdekjen e Mons. Simon Filipaj, kalon famullitar në Shën Gjergj e Kllëzën, prej vitit 1999 deri 2001. Në këtë kohë pranon titullin e nderit “Monsinjur” nga Shenjtëria e Tij Papa Gjon Pali II, me 05 maj 1999. Pleqërinë e kaloi në Tivar, te Arqipeshkvi, Imzot Zef Gashi, që nga fillimi i vitit 2001 deri 2008.

Në vitet e fundit të jetës së tij, në kohën e sëmundjes, i kanë shërbyer Motrat Françeskane të Zojës së Papërlyer në Podgoricë, ku edhe ndërroi jetë.

Meshën e Dritës në Kishën e Zemrës së Krishtit në Podgoricë, e ka udhëhequr Mons. Zef Gashi, Arqipeshkëvi i Tivarit. Së bashku kanë concelebruar edhe Mons. Ilija Janjić, Ipeshkëvi i Kotorri dhe 20 meshtarë nga Mali i Zi, Kosova e Shqipëria. Në Meshë kanë marrë pjesë shumë Motra Françeskane të Zojës së Papërlyer dhe shumë besimtarë nga Podgorica, Shën Gjergji, Bishtazhini e Shkrelë.

Varrimi i Don Miloradit u bë të shtunën, më 28 mars, në ora 12.00 në Pozhega (Kroaci), ku janë edhe varrezat familjare të familjes Defar.

Don Mila, meshtar shembullor

Dioqeza e Kosoves (Ipeshkvia e Prizrenit), ka humbur një Meshtar të devotshëm, i zellshëm, i urtë dhe i dashur për të gjithë besimtarët. Vdes një ndër meshtarët më të përsipirtshëm dhe i dhënë për fenë e Kishën, sidomos uratën, që kam pas rast të njoh gjatë qëndrimit tim në Tivar. Kam ndenjë shumë orë me të. Kishte shumë qef të luan-të shah.

Herën e fundit e kam taku në Kuvendin e Motrave Françeskane, në Podgoricë. E kam vështirë të përshkruaj përmallimin që ka pas kur ka concelebruar Meshën Shenjte me Imzot Zef Gashin, sidomos kur e ka marrë Kungimin.

Don Milë, dëshiroj të falënderoj edhe me anë të këtij artikulli, për të gjitha ato çaste që kemi kaluar së bashku. Mendimet dhe sjellja jote do të më mbesin gjithmonë në kujtesë. Jam i gëzuar, njëkohësisht ndjej dhimbje që kalove nga kjo jetë tokësore.

Të falënderoj për shembullin se si jetohej jeta meshtarake, për ato çaste me të cilat i kam kaluar me ty. Kam vërejtur përvujtërinë tënde, që më ka forcuar në rrugën time meshtarake. Jam i bindur që Zoti do ta shpërblej gjithë mundin, që e ke treguar për popullin shqiptar.

Don Mila, faleminderit për kontributin e jetën tënde se ia kushtove Krishtit, Kishës e popullit shqiptar.

Imzot Zef Gashi gjatë pretkut në Meshën e Dritës tha: “Don Mila, ka udhëtuar me kal, biçikletë, motor, dikur edhe me makinë. Edhe pse me origjinë kroat, por me zemër shqiptar. Ishte figurë e jashtëzakonshme e një meshtari të thjeshtë, të durueshëm, plotë dashuri e mirësi ndaj çdo personi, krejtësisht i përkushtuar për Kishën e Zotit. Ishte bekim i dioqezës sonë”.

Gëzohu e lumturo, o meshtar i dashur në Parajsën e qiellit – lutu për ne shëftarët e kësaj jete!

Requiem aeternam dona ei, Domine, et lux perpetua luceat ei. Requiescat in pace. Amen!
Jepja, o Zot, pushtimin e pasosur, e ndritë drita e pambaruar!
Pushoftë në paqe Amen.



Percjellja e fundit për në amshim



Bisedë me Prof. Engjëll I. Berishën, aktivist në Shoqatën për të Zhdukur
“27 Prilli 1999-Meje” në 10-vjetorin e Masakrës së Mejës dhe Korenicës

Masakra e Mejës dhe Korenicës i ka dritaret sy të nënave që presin t'u kthehen të vdekurit për ta pajtuar dhembjen



Drita: Çka ka ndodhur më 27 prill të vitit 1999 në Korenicë e Mejë të Gjakovës, kur dihet se aty është kryer masakra më e madhe gjatë luftës së fundit në Kosovë, duke lënë qindra shqiptarë të vrarë e të zhdukur.

Engjëll I. Berisha: Masakra e njohur me emërtimin “Masakra e Mejës dhe Korenicës”, është bërë më 27 prill të vitit 1999, në fshatin Korenicë e në Mejë të Gjakovës. Këtë emërtim e merr ngase e tërë vrasja e njerëzve (të gjithë shqiptarë), dhe zhdukja e tyre duke i ndarë familjet bëhet në Korenicë dhe në Mejë të Gjakovës. Në të vërtetë ka ndodhur një nga çmenduritë e mizorisë serbe, përvjetorin e së cilës në prillin që e lamë ka mbushur 10 vjet. Për familjarët, por edhe për vetë historinë e Kosovës është mbushur një dekadë trishtimi dhe dhembje e pandërprerë për mijëra të prekur nga vrasja me masive e kryer nga policia dhe ushtria serbe në vitin 1999. Ajo që trishti më së shumti, ishte zhdukja e kufomave, gjatë së cilës u përpoqën që të zhdukin gjurmët e krimit me çdo kusht, qoftë edhe duke djegur trupat e të vrarëve, në afërsi të kryeqytetit serb, Beogradit. Kjo ishte masakra e Mejës, dhe këto ishin viktimat e para të një strategjie të spastrimit të zonës së kufirit me Shqipërinë.

Edhe këtu bëhej taktikë vepërimi. Disa i vrasin aty për aty sipas skenarit nëpër shtëpi madje edhe duke i djegur, disa i dëbojnë dhunshëm nga shtëpitë ku një tjetër grup policësh dhe paramilitarësh i ndalon në fshatin Mejë të shkolla. Shumë nga ata i vrasin, pastaj i plaçkisin familjarët, ua marrin të gjitha dokumentet dhe sillen egërsisht duke i deportuar përtej kufirit, shumicën për në Shqipëri.

Nga ai moment nuk u panë më kurrë, statusi i të cilëve quhej, “të zhdukur”, - deri në majin e vitit 2003, kur edhe identifikoh-

en dhe riatdhesohen 43 kufomat e para.

Bilanci tragjik, qindra të vrarë.....

Drita: Numri i të vrarëve, që kishin dhe një status tjetër, “të zhdukur”, ishte shumë i madh dhe me qindra. Cila është shifra e saktë?

Engjëll I. Berisha: Masakra e Mejës në fund rezultoi me 377 të zhdukur e të vrarë. U gjetën vetëm 28 kufoma të mbetura, pa u zhdukur nëpër fshatra dhe u varrosen nga familjarët me të mbaruar lufta. Të zhdukur u konsideruan 349. Janë të identifikuar dhe të rivarrosur deri më tani 351. Kanë mbetur në listën e të zhdukurve edhe 26. U dëbuan nga banimet më shumë se 20 mijë banorë. U rrënuan më shumë se 3000 shtëpi banimi. Sipas dëshmitarëve, disa prej të vrarëve nëpër shtëpitë e tyre, (25 - 30 veta), janë bartur dhe futur në një gropë masive në varrezat afër rrugës në mes të fshatit Korenicë. Më vonë kufomat janë nxjerrë nga aty dhe janë dërguar në Batajnicë, ku janë hapur 8 varreza masive me shqiptarë në një poligon ushtarak.

Ata që u masakruan në këto dy fshatra ishin banorë të Zonës Reka e Keqe, banorë të fshatrave nga Juniku, Batusha, Molliqi, Brovina, Ponosheci, Smolica, Babaj Bokës, Shishmani, Duzhnja, Guska, Nivokazi, Dobroshti, Shishmani, Rracaj, Pacaj, Rripaj, Madanaj, Neci, Ramoci, Skifajni, Baballoqi, Mejë e Korenica.

Drita: Kjo masakër ka përmasa konfesionale, gjeografike dhe kategori njerëzish, si fëmijë, të moshuar, femra dhe djem shumë të rinj. Si e shpjegoni ju këtë rast.

Engjëll I. Berisha: Vëri shenjë vëllait sa të duash, vërja ndarjen konfesionale, një gjak është që kur ishin gjallë i bënte të jenë

po ata shqiptarë, fajtorë për nga gjuha e gjaku, fajtorë vetëm pse ishin të tillë. Ata i kanë vrarë pse kanë qenë barabar hisedarë të historisë, pse u ka takuar ta trashëgojë fatin e të parëve të tyre. Ata që në këtë vend sollën armë për të na vrarë me shekuj, po ata i sollën dhe na i ngjiten në ballë edhe shenjat për të na bërë të diferencueshëm, por që kjo punë nuk pati sukses kurrë.

Lufta e fundit në Kosovë në mes regjimit të Serbisë dhe shqiptarëve i ka dhënë fund propagandës serbe dhe të Akademisë së tyre, të cilën e ka propaganduar për shekuj me radhë. Mbrotja e civilizimit të cilën ata e propagandonin më nuk pin ujë as të vetë serbët. “Civilizimi” i tyre ishte mbrotja e krishterimit, gjë që nuk është e vërtetë. Në Korenicë, në Mejë e në Guskë vet e kanë demantuar këtë fakt. Por jo vetëm këtu, edhe në shumë zona të tjera. Pastaj, cili civilizim jep urdhëra të digjen njerëz, të vriten, të shkatërrohet

një popull i tërë? Në masakrën e Mejës dhe Korenicës, janë vrarë qindra katolikë që kanë krijuar vëllazërinë shqiptare, duke u vrarë së bashku me shqiptarë të konfesionit tjetër dhe duke u varrosur së bashku. Kjo masakër përfshin edhe shumë fshatra. Vetëm në Korenicë janë të vrara katër femra, pastaj moshat prej 14 deri në pleqëri të shtyrë.

Drita: Bartja e kufomave aq larg, paraqet një rast interesant, aq sa është vetë tragjika e ngjarjes dhe ky është një fenomen që nuk ndodh në çdo luftë, edhe pse ndodh fshehtë e të vrarëve.

Engjëll I. Berisha: Ndonëse në luftë priten të gjitha. Edhe pse në Kosovë për kohë të gjatë kishte luftë të pashallur, por lufta speciale e kishte përgatitur mendjen e njeriut për të gjitha. Do të thotë, nëse e kemi menduar vrasjen, kurrë nuk e kemi menduar zhdukjen e kufomave.

Unë po shfletoj faqe historike dhe nuk e di nëse ndonjë regjim i ka bartur kufomat më shumë se 500 kilometra larg vendit të ngjarjes. Ata kanë udhëtuar bashkë me kufoma, të kontaminuara, bashkë me copa mishit të njeriut dhe kufoma të karbonizuara. Pasta, tragjika është se duke mos e ditur nëse janë të gjallë apo të vdekur, kanë lënë familjet në ankth, që ky ankth ktheu shoqërinë në një kategori me kriza edhe psikike edhe sociale dhe shumë të lënduar në shpirt. Edhe sot po i vuajmë këto kriza.

Jo veç historia, por popullit shqiptar, i përsëritet edhe harresa

Drita: Pse aq rrallë përmendet Masakra e Mejës?

Engjëll I. Berisha: Pse se jemi të prirë ta dënojmë vetëveten. Nëse ndonjëherë jemi vonuar në histori, (gjë e cila ka ndodhur shpesh), tani kur nuk na pengon askush, prapë vono-





hemi. Kam frikë se do ta marrim dënimin, që do ta paguajmë edhe më shtrenjtë. Më duket se ky 10-vjetor përkujtimi, sikur na shtyn të bëjmë historinë "për të kujtuar" e jo "për të mësuar" nga historia që ajo të mos përsëritet më. Por duke na detyruar të heshtim e të mos flasim për tragjedinë. Heshtja jonë sipas ndërkombëtarëve kërkon prej nesh të tregohemi "humanitarë" (thujse nuk jemi të tillë) dhe na e mbjell harresën. Duke mos mësuar nga ajo golgotë e Mejës e ndodhur 10 vjet më parë, si dhe golgotat e tjera anë e mbanë Kosovës, sot na sfidon arroganca riokupuese e të njëjtit shtet terrorist. Na okupon edhe arroganca jonë nëse e shfaqim dhe duket sikur po e tolerojmë. Duke e heshtur historinë për arsye "humaniste" ata e falsifikojnë atë duke arritur të marrin rolin e viktimës.

Drita: Ju personalisht dhe shumë nga shoqatat e familjare keni vrapuar për shumë kohë nëpër vendvarreza, nëpër identifikime dhe në Morgun e Mjekësisë Ligjore. Me çfarë force e keni bërë këtë?

Engjëll I. Berisha: As shqiptarët fitimtarë të luftës, as ata që na ndihmuan, pas çlirimit më 1999 nuk ishin faktorë sovranë

të Kosovës. Ishte krejt dikush tjetër: Këshilli i Sigurimit, OKB, UNMIK-u, dhe "bashkësi" të tjera ndërkombëtare, të cilat, duke dashur të ndërtojnë një bashkësi abstrakte midis viktimës dhe xhelatit, arritën që t'i barazojnë krimet me sakrificën. Shqiptarët nuk kishin qasje në Beograd. Beogradi fshehte kufomat. Doli analiza AND dhe dolën mbledhja e të dhënave faktike që më shumë duhej t'i bënin familjarët sesa ata vet. Në këtë rast familjarët ishin krejt të paditur por e kishin forcën emotive që i pengonte dhe nuk lente shumë mundësi për punë. U nisëm me emërtime të Shoqatave nga familjarët. Unë bëra shumë vrapë nëpër morgun e kufomave, në vendvarreza ku hapeshin dhe bëme shumë zhurmë në konferenca, në tubime masive me të huajt dhe me ekspertë që vinin e shkonin pa ndonjë rezultat të madh. Në morg shpesh jam ndodhur në mes qindra eshtrave që nuk diheshin të kujt janë. Organizuam më shumë se 30 rivarrime edhe me nga 43 kufoma.

Unë nxora edhe një periodik, gazetë mujore për të zhdukur që e emërova "27 prilli" dhe vazhdon të dalë duke bartur kujtimet dhe ngjarjet e masakrave në Kosovë. Kjo pra, ishte punë e jona për dhjetë vjet dhe vazhdon të jetë

e tillë ngase kemi ende shumë kufoma të paidentifikuara. Nga Masakra e Mejës kërkohen edhe 26 të zhdukur. Nga Gjakova si komunë kërkohen edhe 72, ndërsa nga e tërë Kosova kërkohen edhe 1972 të zhdukur.

Drita: Pas gjitha këtyre ngjarjeve, si e përshkruani ju sot Korenicën dhe shumë nga fshatrat tjera që përjetuan këtë tragjedi?

Engjëll I. Berisha: Ne po e hapim varrin tonë që tash e 10 vjet, duke e lënë të zbrazët, të na kthehen eshtrat. Presim të na i kthejnë të humburit, derisa okupatori zgërdhiet me tragjedinë tonë. Në Korenicë, në Meje, Guskë, Junik, Dobrosh dhe shumë fshatra tjera, jeta është normalizuar krejtësisht. Fëmijët janë rritur dhe janë duke u shkolluar. Nën atë kanë mëkëmbur jetën edhe pse ato e dinë me sa vështirësi bëhet kjo gjë. Aty po punohet në punë bujqësie dhe në edukim të fëmijëve. E thashë më lartë krejt çka e ka rënduar situatën është zhdukja e kufomave dhe mos gjetja e tyre për kohë të gjatë. Edhe pse nuk e kemi numrin e tërë të të gjeturve, jemi të vetëdijshëm se janë të vrarë dhe vazhdojmë të kërkojmë. Por nuk guxojmë të ndalemë së jetuari sikur e ka thënë Zoti Krijues, ngase ky edhe ishte çnimi i lirisë që e gëzojmë sot. Ne as nuk guxojmë të mbjellim pesimizëm. Për të vrarët do të lutemi, ndërsa për të gjallët do të përkushtohemi. Ky është dhe obligim ynë moral, i prindit, i mësuesit, i familjarit dhe i fqinjit të mirë. Mos të jetojmë më me urrejtje, por ti kthehemi jetës.

Drita: Aty në Meje, sot është projektuar dhe një Kompleks Memorial me varre me kryq e me piramidë, një memorial i rrallë ndër ne i këtij lloji. Cili është qëllimi?

Engjëll I. Berisha: Krejt

afer kufirit të përdhunshëm, në fshatin Meje të Gjakovës, është një lokacion perëndimor brenda dimensionin të gjerë evropian, lokacion varrezash të dëshmorëve të luftës së fundit. Një shenjë emri në gjeografinë fragmentare të kulturës së një kombi. Kush bën fjalë si shkenca për kombin, njësi identifikues i kombit, njësi karakterizues i unikimit karakteristik i diversitetit brenda një tipari historik të tij? Zanafilla, fillimi i të qenit, dhe fundi deri në këtë moment kohe, që vazhdon deri nesër dhe nisët për në pafundësi. Në midis të këtyre dy polariteteve kohore, fillimit dhe fundit, del një shenjë e emrit tim, e përveçme. **Flet shqip!**

Ata dëshmorë të persektuar nga vandalizmi serb, që tash pu-

shojnë në varrezat që janë kuriozitet botëror, së gjalli kanë jetuar bashkë duke u marrë vesh shqip. Bashkë janë në një copë toke të vogël edhe të vdekur. Ata si flasin tash? Nuk flasin më. Heshtin. Dhe çka i bën të përbashkët nëse jo gjuha amnore e të gjithë atyre, gjuhë që tashmë nuk mund ta dëgjosh. I bën bashkë diçka më e madhe edhe se gjuha e tyre. Janë bashkë aty, me shenja fetare të ndryshme, por që janë shenja që shpëgojnë shqip domethënien e fatit të tyre që quhet Histori e Përsëritur, histori që përsërit vetveten deri në vijën e fundme të Rubikonit.

Bisedoi:

patër Ndue Kajtazi

Fjala e patër Ndue Kajtazit në Mejë më 1 gush 2003, me rastin e rivarrimit të një numri të madh të të vrarëve më 27 prill 1999

Do të mundohem të shprehem si Patër Anton Harapi në një rast të tillë.

Ndaluni pak!

Ku shkon, o burra?!

Dy fjalë ka Gjakova, këtu në log të kuvendit, para se të ndahemi. Erdhët të pushoni këtu në dheun tuaj, ku së pari i patë rrezet e ëmbla të diellit, ku si filiza të shëndosha, të gëzueshëm e rritët shtatin, këtu ku Kosova ju rriti e ju shndriti.

Le të lavdërohet me ju Reka, Malësia e Gjakova, por edhe Meja, vendi ku ju nuk vdiqët, por u lindët për atdhe.

Jo nuk ju lëshon Gjakova, ëmbël pa ju puthur, përmallshëm pa derdhur dy pika lotësh, lot gëzimi e pikëllimi mbi eshtrat tuaj.

Eshtra të pavdekshëm ju falem!

Po, të pavdekshëm, sepse në vete ruani një visar të çmueshëm, atë ide e cila e patundur do të mbesë ndër ne dera sa të jetë Kosova.

E ju, o burra, që edhe të vdekur na flisni, e të fikur – shndrisni, lëshojeni një zë kumbues e tregoni djalërisë shqiptare çka ju ushqeu idealin, kush ju mbajti gjallë karakterin e si u bëtë të pavdekshëm?

Tregoni se s'do të vdesë Kosova deri sa gjaku juaj i njomë e i gjallë do të vlojë në kujtesën e shqiptarëve. Me tërë fuqinë tuaj vigane bëjani një urim Kosovës. Uroni mbarësi e përparim, paqe e drejtësi.


Por çojeni edhe zërin tuaj kundër atyre që rrënojnë atë që ju ia ngritët themelet.

Nuk ju pyes si qubeni e nga jeni, ngado qofshi të bardhë qofshi, këtu ku do të pushoni, do të shndritni si flori. Ideali juaj më tregon se kush jeni, vdekja juaj më dëshmon përse jetuat. Ne e dimë kush ju vrau, por më me rëndësi është t'a dimë së përse ju vrau.

E dimë se besuat në Zot, e ai Zot që është një, tani shpirtin tuaj e ka në dorë dhe e gëzoni pagën e Tij.

Zotëri e familjarë të nderuar, nuk do të ju vonoj më. Merrni këto visare të çmueshme e varrosni, merrni këta eshtra e vendosni në tokën e vet, por le të mbesin si nishan e pikë orientimi për të gjithë neve, shëmbëllesë ideali dhe forcë për bashkim kombëtar, e t'i dëftojmë botës se shqiptarët ngado që janë, nga Lindja e nga Perëndimi, nga Veriu e nga Jugu, të krishterë e myslimanë, të gjithë janë shqiptarë të vërtetë, e njerëz që dinë të sakrifkohen për gjëra të shenjta.

Zoti i bekoftë familjet tuaja, e ju pushofshi në paqe!



Monumenti i martirëve të luftës në Korenicë

Pali është misionari më i dalluar i Krishtit në historinë e njerëzimit

■ SHKRUAN:

Don Marjan UKAJ, Toronto

Një fjalë e urtë nga Kameruni thotë: "Nëse dikush thotë se të do, shikojë çka bën për ty!" Kjo më së miri dëshmonet në jetën dhe veprimtarinë e palodhshme misionare të shën Palit, madhështia e të cilit vështirë mund të kuptohet nga njerëzit e brishtë të kohës, siç jemi ne. Studimi që vijon, na tregon se çka mund të bëjë njeriu, i cili ia fal jetën e vet Krishtit dhe lejon që të veprojë nën frymëzimin e Shpirtit Shenjt. Kemi theksuar se Pali me përpikërinë më të madhe e zbatoi urdhrin e Krishtit: "Shkoni e bëni nxënësit të mi të gjithë popujt! Pagaizoni në Emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt! Mësoni të zbatojnë gjithçka ju kam urdhëruar! Dhe, ja, unë jam me ju gjithmonë deri në të sosur të botës! (Mt 16, 19-20)" A ishte vetëm dëgjues i Fjalës, apo edhe zbatues i Saj, le të konkludojmë pas përkohësimit të tri udhëtimeve të tij misionare.

Udhëtimi i parë misionar (Vap 13, 1-14, 27)

Qysh nga fillimi bashkësia e krishterë në Antioki kishte besimtarë shumë të mëdhenj. Me siguri, më të rëndësishmit ndër ta ishin Barnaba dhe Sauli. Ja se si filloi veprimtaria e tyre misionare: "Një ditë, ndërsa po kryenin shërbësit hyjnorë e po agjëronin, Shpirti Shenjt tha: 'M'i ndani Barnabën e Saulin të kryejnë veprimtarinë, për të cilën i kam thirrur.' Atëherë, pasi agjëruan dhe u lutën, vunë duart mbi ta dhe i lejuan të shkojnë (Vap 13, 2-3)." Ndër shumë profetë dhe mësues, Barnaba radhitet i pari, ndërsa Sauli i fundit. Këta ishin dy persona moralisht dhe intelektualisht më të fortit, të cilët bashkësia e parë e apostujve i përgatiti dhe i dhuroi për ungjilëzim në Qipron, prej nga vinte Barnaba, dhe në Azinë e Vogël. Siç shihet nga Veprat e Apostujve, vetë Shpirti Shenjt i ndau dhe i dërgoi në veprimtari ungjillore. Në fillim atyre iu bashkua edhe nipi i Barnabës, Gjon Marku, më vonë ungjilltar, i cili shpejt u tërhoq. Apostujt depërtuan deri në Sallaminë, qytet porti, ku predikuan nëpër sinagoga, pastaj shkuan në Paf, që ishte kryeqyteti i Qipros, në të cilin u kthyen dy persona shumë të zë, prokonsulli Sergi Pauli dhe magjistarit dhe astrologu Elimi, të cilët ishin të pasur verbim. Si të lajmëron Shkrimi Shenjt mbi të: "Atëherë Sauli, që quhet edhe Pal, plot me Shpirt Shenjt, ia nguli sytë

dhe i tha: 'O njeri plot gënjeshtre e dredhi, bir i djallit, armik i betuar i çdo drejtësie, a nuk do të pushosh t'i shtrembërosh udhët e drejta të Zotit? Ja, pra, tani dora e Zotit mbi ty: do të verbohesh e deri ne urdhër tjetër, nuk do ta shohësh më dritën e diellit! Aty për aty ra mbi të terr e errësirë: ecte andej e këndej duke kërkuar t'ia japë ndokush dorën. Kur prokonsulli pa se çka ngjau, besoi i bindur plotësisht në mesimin e Zotit (Vap 13, 9-12).

Kush mund ta kuptonte më mirë se Pali se çka do të ndodhte pas këtij verbimi? Me siguri mendoi në vete: dëgjo mirë, se po të flet ai që dikur ishte plot gënjeshtre e dredhi dhe armik i betuar i çdo drejtësie e që tani ka pushuar t'i shtrembërojë udhët e drejta të Zotit. Dëgjo dhe mos u frikëso, sepse verbimi është ilaç, i cili të shëron dhe të ndihmon t'i harrosh të gjitha veprat e djallit. Dëgjo dhe bindu se s'ke kah ia mban, sepse je i zënë nga Ai, që është shumë më i fortë se ti. Mos ke frikë. Dielli prapë do të shndrisë për ty, por jo më ai diell i botës. Krishti do jetë dielli yt. Rrezet e tij do shndrisin gjithmonë rrugën tënde. Tash e tutje të duhen sytë e ri, të nevojitet zemra e re, sepse në ty po fillon një jetë e re, e cila nuk njeh perëndim. Mos ke frikë nga unë, se s'jam më përndjekës, por përcues i Fjalës së Zotit. Unë e di mirë kush është ajo Dritë. E di se ajo më së miri shndrit në errësirën e plotë. Mos ke frikë se errësira e jetës sate po merr fund. Ja, po e përjeton braktisjen e botës. Ke nevojë që dikush të ta shtrijë dorën. Ja, pra, dora e Zotit është mbi ty. Prej tashti ajo do të prijë, siç më priu edhe mua. Çohu dhe falja jetën Krishti Zoti!

Sipas shën Jeronimit, në këtë moment Sauli bëhet Pal, duke e pranuar emrin e këtij magjistar, ndërsa Augustini është i mendimit se emri i tij vjen nga shtatvogëlia e tij (paul= i vogël).

Pali e zgjodhi Qipron që kishte një varësi nga Siria dhe Cilicia, ku ishte përhapur ungjilli qysh në kohën e Shtjefnit (Vap 11, 20) dhe lundroi në Pergë të Pamfilisë, ku u nda Marku (Dj 13, 13), prej nga kaluan nëpër kodrat e Pisidisë, ku u sulmuan nga hajnat. Synimi i tyre ishte arritja në koloninë romake të Antiokisë, shtatë ditë rrugë nga Perga. Këtu Pali foli mbi thirrjen e Izraelit dhe mbi providencën e dërgimit të Mesisë (Vap 13, 16-41). Qëndrimi i këtyre dy misionarëve në Antioki ishte i gjatë për shpalljen e Fjalës së Zotit në mbare vendin (Vap 13, 49). Këtu përmes intrigave të judenjve u dha një deplotë internimi kundër tyre, prandaj

ata u larguan në Ikon, 3 deri në 4 ditë rrugë, ku u pritën me të njëjtën përndjekje nga judenjtë dhe paganët. Armiqësia e judenjve i detyroi të arratiseshin në koloninë romake Listra, rreth 30 km larg, ku u përndoqën prapë nga judenjtë e Antiokisë dhe të Ikonit. Megjithatë, fal ndihmës së Zotit, ia dolën të kalonin në Derbë, diku 40 km larg, në kufi të provincës së Galisë, prej nga u kthyen në Jerusalemin.

Në mënyrë të posaçme Pali dhe Barnaba përjetuan kryeq të paharueshme në tri qytete: në Antioki në e Pisidisë, Ikon dhe Listër.

Antiokia e Pisidisë

Fjalimi i Palit në sinagogë (Vap 13, 16-41) mahnti shumë judenjtë dhe proselitë, por "Judenjtë, kur panë të gjithë atë shumicë populli, i kapi smira, zunë t'u kundërshtojnë me të shara fjalëve të Palit (Vap 13, 45), ngulën disa gra në shenjë që besonin në Hyjin dhe krejtë e qytetit e shkaktuan një salvim kundër Palit e Barnabës dhe i dëbuan prej vendit të tyre. Ata atëherë e shkundan pluhurin e këmbëve të veta si dëshmi kundër tyre dhe shkuan për Ikon (Vap 13, 50-51)."

Shën Luka i thekson tri lloje të kundërshtarëve të Palit. 1. Judenjtë, mbrojtësit, por jo edhe zbatuesit e Ligjit, nuk mund ta imagjinonin "tradhtarin" Jezus, as Palin, apostullin e tij. 2. Gratë e përshtirshme dhe fanatike, të cilat i manipuluan dhe nxitën judenjtë, për t'i guajtur dhe për t'i larguar apostujt "heretikë" me gurë dhe me të gjitha mjete që i posedonin. 3. Administrata e qytetit që donte qetësi dhe rregull në qytet, jo religion dhe vlerë, përpos kur ato kishin të bëjnë drejtpërdrejtë me politiken e tyre ditore. Politikantët janë në anën e atyre që japi më tepër vota, përkrahje, vlerë në këtë botë, e jo në atë tjetër.

Ikon

Edhe në Ikoni hynte në sinagogë dhe predikuan kështu që u kthyen shumë prej judenjve dhe grekëve. Por, judenjtë i ngritën pagantë kundër tyre. Megjithatë, ata këtu ndënjën një kohë të gjatë. Qyteti atëherë kishte 60.000 banorë, sot mban emrin Konya dhe ka rreth 600.000 banorë të gjithë të fesë islame. Në qytet në atë kohë kishte hebrej dhe paganë që u bashkuan kur ishte në pyetje përndjekja e apostujve, si dikur Pilati dhe Herodi (Lk 23, 12). Apostujt guximshëm predikonin, ndërsa kundërshtarët edhe më guximshëm i sulmonin. Apostujt e kishin në gojë Fjalën e Zotit, ndërsa populli gurët. Mezi shpëtuan dhe shkuan në Listër

dhe Derbë.

Listër

Pas një rrugë 40 km apostujt i pritë urretja edhe më e flaktë në Listër. Këtu guajta me gurë ishte më e rrëmbyeshmja, sa që menduan se Pali ishte i vdekur. Si të ishte ndonjë egërsirë e hodhën jashtë mureve të qytetit, ku e gjetën nxënësit e tij dhe tinëzishit e futën në qytet, e pastruan dhe ia lanë varrët. Ishte ky djaloshi me emrin Timote, i cili nuk mund t'i ndalte lotët nga trishtimi. Mbi këtë shkruan vet shën Pali në 2 Tim 1, 4: "Kur më bien në mend lotët e tu, më kap një dëshirë e madhe të shoh ty që të mbushëm me gëzim." Në 2 Tim 3, 11 ndër tjera i shkran Timoteut: "Se ç'salvime kam sprovuar, por prej të gjithave Zoti më shpëtoi." Çka është e rëndësishme në Listër Pali e shënoi një sakat dhe si shpërblim për këtë e guajtën me gurë. U kthyen prapë në Ikon dhe në Antioki ku e "bashkuan Kishën dhe treguan gjithçka Hyji bëri me anë të tyre dhe se si Hyji ua hapi paganeve derën e fesë (Vap 14, 27)." Në këtë udhëtim të parë misionar që zgjati 3 deri në 4 vjet, nga viti 45 deri në vitin 49 pas Krishtit, apostujt bënë rreth 2.500 km rrugë. Është e pamundur që Pali të mos ketë menduar si dikur edhe ai e përndoq emrin e Krishtit dhe të mos ketë falënderuar Zotin që e nxori nga errësira e urretjes. Problemi në lidhje me statusin e paganëve në Kishë ishte i rëndësishëm së madhe. Disa të krishterë çifutë, të ardhur nga Jerusalemi, ishin të mendimit se paganët duhej rrethprerë. Pali dhe Barnaba i kundërshtuan këto qëndrimi, kështu u vendos që të thirrjet një mbledhje në Jerusalemin për ta zgjedhur këtë problem. Në këtë mbledhje që u mbajt në vitin 49 Pali dhe Barnaba e përfaqësuan bashkësinë e Antiokisë. Pjetri ngulmoi lirinë e paganëve, Gjoni e përkrahi por njëkohësisht kërkoi që paganët t'i respektojnë të lirohen nga ligji i Mojsiut. 2) që të krishterët e Syrisë dhe Cilicisë të përmbahen nga flajimi i hyjnyne dhe nga fëlligështia. 3) që këto urdhëra t'i marrin jo si ato që dalin nga ligji i Mojsiut, por në emrin e Shpirtit Shenjt. Kjo ishte një fitore e plotë e ideve të Palit. Këto argumente e binden edhe Pjetrin, kryeapostull (Gal 2, 11-21).

Udhëtimi i dytë misionar (Vap 15, 36 - 18, 22)

Fillimi i rrugës së dytë misionare u realizua menjëherë pas mbledhjes së Jerusalemit dhe ishte i kush-

tëzuar nga një diskutim i ashpër në mes të Palit dhe Barnabës, për arsye të Gjonit që quhej Mark, të cilin shën Pali nuk pranoi ta kishitë për shoqëres. Përfundimisht u ndanë njëri prej tjetrit dhe kurrë më nuk u takuan: "Barnaba mori me vete Markun e shkoi me barkë për Qipër, kurse Pali mori me vete Silven." Pali dhe Sila përkshuan 20 qytete. Ndarja në këtë rast ishte në dobi të fesë, sepse shumë më tepër u predikua Ungjilli. Silva ishte qytetar romak, si edhe vetë Pali dhe kishte ndikim në Kishën e Jerusalemit. Ata së bashku shkuan nga Antiokia në Tars dhe gjatë rrugës i përhapën vendimet e mbledhjes së Jerusalemit, nga Tarsi shkuan në Derbë, ku e vizitoi Kishën që e kishte themeluar gjatë udhëtimit të parë misionar. Këtu nuk kishte ndodhur asgjë e posaçme për jashtim të zgjidhjes së Timoteut, të cilin pasi apostulli lejoi ta rrethprej, për arsye se ishte "bir i një hebreje të pagëzuar dhe i një greku", e bindi që ta shoqëronte atë sa ishte në Listër. Për këtë arsye u bë shumë më i lehtë afrimi ndaj judenjve. Duket se në Antioki e Pisidisë, përmes intervenimit të Shpirtit Shenjt, ndryshoi plani i udhëtimit. "E kaluan Frigjinë dhe krahinën e Galacisë sepse Shpirti Shenjt ua ndaloi të predikonin fjalën në Azi. Kur arritën në kufijtë e Mizisë, deshen të hyjnë në Bitini, por ua ndaloi Shpirti i Jezusit, atëherë kaluan vetëm në Mizi dhe zbritën në Troadë (Vap 16, 6-8)." Ata nuk kishin drejtë të predikonin në Galaci, por, siç duket, u bë e mundur për arsye të një sëmundjeje të papritur të Palit (Gal 4, 13). Duke kërkuar ilaç, Pali e takoi Lukën, mjek, i cili iu bashkua veprës misionare, duke mos patur mundësi më të largohet nga Pali i sëmurë. Këtu në Troadë Pali pati vegim. Iu duk një maqedon, i cili i tha: "Kalo në Maqedoni e na ndihmo (Vap 16,9)!" Ai e kuptoi se bëhej fjalë për porosinë e Zotit, prandaj u nisën për Greqi: në Samotarkë, në Neapol, prej ku shkuan në Filipe, qytet kryesor i asaj province të Maqedonisë. Roma e zaptoi Greqinë me armë, Greqia Romen me urti, ndërsa Jerusalemi e zaptoi edhe Romen edhe Greqinë me Fjalën e Zotit. Prej Filipe nëpër Ampifol arritën në Apoloni, Selanik dhe Berejë, pastaj në Athinë dhe Korint. Pali nëpër Kenhrejë dhe Efes arriti në Jerusalemin. Ky udhëtim madhështor ishte i gjatë pak më pak se 5000 km. Në çdo vend, diku më shumë, e diku më pak, i pritnin prangat dhe vuajtjet. Më të rëndësishmet prej tyre janë: në Filipe, Selanik, Berejë dhe Korint.

Filipe (Vap 16, 22-24)

Pali po përgatitej të shkelte Evropën. Gjithkund ku shikonte ndonjë sinagogë, hynte në të dhe u predikonte hebrenjë dhe proslitëve (proslitetë ishin grekët që kaluan në judaizëm). Aty ku rastiste thyerja, dorëzimi, tërheqja, gjë që gjithmonë ndodhte, e themelonte Kishën e re me rishtarë, si bërthamë të vet. Qëndronte në të njëjtin qytet derisa nga intrigat e judenjë nuk e përmëdhnin dhe detyronin të gjente ndonjë vend të qetë. Megjithatë, kishte edhe përjashtime nga ky plan. Në Filipe, qytet i banuar prej romakësh ku s'kishte sinagogë. Në Filipe Pali përjetoi ditë të mira. E ktheu një grua me emrin Lidi, prej qytetit të Tiatiarit, e cila është misionarja e parë që e pranoi krishterimin në pjesën e Maqedonisë evropiane. Pali këtu e liri edhe një sklave, e cila ishte e pushuar nga shpirtat e ndytë, nuk lejoi që djalli ta lavdërojë dhe tha: "Po të urdhëroj në Emër të Jezus Krishtit, dil prej saj (Vap 16, 16-18)." Por, judenjtë, në krye me priftërinjtë e tyre, të nxitur nga smira, nuk mund të shikonin përparimin e krishterë, prandaj i qitën para pretorëve dhe thanë: "Këta njerëz po na trazojnë qytetin. Janë judenjë dhe shtrijnë dokë, të cilat ne, romakët, nuk mund t'i pranojmë as nuk mund t'i zbatojmë (Vap 16, 21)." Pali, edhe pse ishte qytetar romak, nuk tregoi, por priti çka do të bëjnë Filipianët. Për habi të apostujve, pretorët vendosën që Pali me shokë të rrihen me frushkuj dhe të hidhen në burg. Ishte me ligj e ndaluar të frushullohej qytetari romak, por Pali këtë e lejoi (2 Kor 11, 24-25). Pse lejoi Pali këtë? Ndoshta dëshirë t'i përgjante Jezusit. Pali e pranoi jo vetëm frushkullimin, por edhe burgimin, i lidhur me pranga në këmbë. Por, "rreth mesnate Pali e Sila luteshin duke i kënduar Hyjit himne. Të burgosurit i dëgjoni. Kur, papritmas, u bë termeti i rëndë, sa që u lëkundën themelet e burgut, përmjeherë u hapën të gjitha dyert dhe të gjithëve u ranë prangat (Vap 16, 25-26)." Pretorët e morën vesh se Pali dhe Sila janë qytetarë romakë, ndërsa ata një ditë më parë i kishin frushkulluar, prandaj vendosën t'i lëshonin fshehtëzi. Por, Pali tha: "Botërisht na kanë frushkulluar pa na pasë gjykuar, ne, që jemi nënshetë romakë, dhe na kanë qitur në burg! E tani duan fshehtas të na lirojnë? Assesi! Por, le të urdhërojnë e të vijnë vetë të na lirojnë (Vap 16, 37)." Pali është i vetëdijshëm se besimi në Krishtin është një privilegj i posaçëm, por privilegj i ril është të pësohesh për Krishtin (Fil 1, 29), prandaj shkruan: "Gjithçka mundem me ndihën e Atij që më jep fuqi (Fil 4, 13)." Nga shtëpia e Lidia kaluan në Selanik ku patën rragatje të ashpër me judenjtë dhe pasi i pagëzuan shumë vetë kaluan në Berezë, prej nga arritën në Athinë.

Selaniku (Vap 17, 1-9)

Nga Filipe në Selanik janë 150 km rrugë këmbësore. Apostujt nuk ndaluan në Ampifol, sepse Pali ia merrte mendja se këtu nuk mund

të bënin mision të suksesshëm. Pas gjithë atyre vuajtjeve, persekutimeve dhe varrëve në trup, si kanë mundur ta bënin gjithë këtë rrugë? Ata nuk dorëzohen. Qëllimi i tyre është arritja në Selanik. Erdhën në Apoloni, të cilin kështu e madhe malore e ndan nga Atosi, që më vonë do bëhet një republikë famoze murgjish me emrin Mali i shenjtë (Hagion oros). Pali i interesonte Selaniku, sepse e dinë se nëse këtu pranohet Ungjilli, lehtë do të shpërndahet si në rrugë tokësore, ashtu edhe në ëto detare. Këtë e vërteton në 1 Sel 1, 8: "Sepse, prej jush, jo vetëm jehoi Fjala e Zotit nëpër Maqedoni e Akajë, por edhe feja juaj në Hyjin aq fort u përhap gjithkrah, sa që s'kemi nevojë të flasin për këtë gjë." Selaniku ishte qytet tregëtar. A ka kund më tepër mundësi manipulimi dhe mashtrimi se sa në treg? Rrena, hajnia, fëlligështia dhe të gjitha nëkatet ishin të theksuara. Prandaj shkruan në 1 Sel 4, 3 "Vullneti i Hyjit është ky: shenjtërimi juaj – të ruheni nga fëlligështia." Pali edhe këtu punoi dhe e fitoi vetë bukën

të. Na shpalluan edhe ne. Ata nuk i pëlqejnë Hyjit. Janë armiq me të gjithë njerëzit duke u mundur të na e ndalojnë t'u predikojmë paganëve që ta fitojnë shëlbimin. Kështu çifutët në çdo kohë e mbushin masën e mëkateve të veta. Por tekembrramja, ra mbi ta hidhërimi i Hyjit." Pali prapë u detyrua të ikte, sepse duhej të predikonte ku ishte e mundur. Kësaj radhe dëshirë t'u drejtohej drejtpërdrejt paganëve. Për këtë arsye së pari shkoi në Athinë, pastaj në Korint.

Athinë (Vap 17, 16-34)

Apostolati në Athinë ishte i jashtëzakonshëm. Këtu nuk bëhej fjalë për judenjtë dhe sinagoga. Pali e mbajti një diskurs të posaçëm para Areopagut, që ishte një përgjigje gjeniale mbi Zotin e krishterë. Fjalimi i Pali në Areopag të Athinës është më brilanti ndër të gjithë. Me një gjuhë filozofike, pikërisht siç ishte vendi, e sqaroi të vërtetën mbi Zotin që në teologji quhet: "De Deo uno". Gjithçka shkoi mbarë, derisa nuk e përmendi të ngjallurit nga të vdekurit.



e një prosliteti me emër Ticije Just që besonte në Hyjin. Këtu ndodhin një gjë e jashtëzakonshme që Krispi, kryetar i sinagogës, besoi në Zotin së bashku me familjen e tij. "Pali zuri vend aty një vjet e gjashtë muaj duke predikuar ndër ta fjalën e Hyjit (Vap 18, 11)."

Kyudhëtim misionar përfundon me një ndodhi të jashtëzakonshme, e cila duhet të ishte shkolle për të gjithë gjyqtarët e botës, që ka të bëjë me qëndrimin dinjitoz të Galionit, prokonsullit të Akajës, para të cilit çifutët e paditën Palin duke thënë: "Ky nxit njerëzit që ta nderojnë Hyjin kundër Ligjit." Galioni, i frymëzuar nga Shpirti Shenjt u përgjigj: "Po të ishte çështja e ndonjë delikti, apo e ndonjë veprë të keqe, ju kisha vështuar, o hebrenj, siç e lyp e drejta; porse, pasi çështja është lidhur me fjalë, emra e Ligjin tuaj, rregullojeni ju vetë; lidhur me këso sendesh unë nuk dëshiroj të bëhem gjykatës. (Vap 18, 12-17)." Menjëherë pas kësaj Pali e lëshoi Korintin dhe shkoi në Efes, prej nga së pari arriti në Cesare dhe pastaj në Jerusalem

kishin qenë të pagëzuar me "Pagëzimin e Gjoni". Ata as që kishin dëgjuar se ka Shpirt Shenjt. "Kur Pali i vuri duart mbi ta, në ta zbriti Shpirti Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë të ndryshme e të profetizojnë." Pas kësaj ngjarjeje Pali për tre muaj predikoi në sinagogë ku përjetoi fyerje dhe sharje, për të cilat arsye u detyrua të tërhiqej kështu që për dy vjet me radhë Pali e gjejmë duke dhënë mësim fetar në shkollën e Tiranit. Ngjarja e dytë ka të bëjë me bijtë e Sceves. Vap 19, 11-20 përkrahë një incident. "Ky nxit njerëzit që të shpallë Vogel, shën Pali qëndroi si shoku tri vjet. E forcoi Kishën, shpalluoi xhakonë, meshtarë dhe ipeshkvij, e dëboi besëtytninë nga populli. Shëroi dhe dëboi daj prej shpirtërave të njerëzve. "Po edhe disa çifut, që endeshin andej-këndej dhe përbenin shpirtat e ndytë të dalin, sprovuam ta thërrasin Emrin e Jezusit Zot, përmbi ata që kishin në trup shpirtat e ndytë. Thoshin: "Po ju përbej në Jezusin, të cilin e predikoi Pali. Këtë e bënin shtatë bijtë e një farë Sceve, kryepfritit çifut. Por, shpirti i keq ua ktheu: "Jezusin e njoh dhe Pali e di, por ju kush jeni?" Dhe njeriu, në trupin e të cilit ishte djalli, u lëshua në ta, i mundi të gjithë dhe, të zhveshurat e të plagosur, ikën prej asaj shtëpie. (Vap 19, 13-16)"

Efes (Vap 19, 21-40)

Synimi i udhëtimit të tretë misionar të Pali ishte Efesi. Aty e pritnin Priscila dhe Akila, por edhe populli, të cilin i kishte premtuar: "Në dashtë Zoti do të vij të ju një herë tjetër (Vap 18, 21)." Pas një suksesi të shkurtër në Antioki u nis të përshkojë krahinën e Galacisë e të Frigjisë duke i përfuruar në fe të gjithë njerëzit" dhe në krahinat e epërta të Azisë qëndrore arriti në Efes. Ai punonte kështu deri në pesë orë në ditë e i mbulonte vet shpenzimet e veta dhe kjo nuk e pengonte në predikimin e Ungjillit. Në sinagoga Pali predikoi tre muaj dhe "mbasi disa kokëfortë që s'donin të binden, filluan edhe të flasin keq e ta shajnë Udhën e Zotit para bashkësisë, Pali i shkëputi marrëdhëniet me ta, i ndau nxënësit dhe filloi të mësojë për ditë në shkollën e Tiranit. Vazhdoi kështu për dy vjet. Kështu të gjithë banorët e krahinës së Azisë – hebrenj e grekë – e dëgjuan fjalën e Zotit (Vap 19, 9-10)." Natyrisht që i duhej t'i duronte tundimet dhe pengesat, disa prej të cilave erdhën nga xhelozia e judenjëve, ndërsa të tjerat nga besëtytnia e paganëve, e cila para së gjithash mbretëronte në Efes. Suksesi i kësaj gjeje ishte djeçia e librave të besëtytnive në vlerë prej 50000 copë argjendi (çdo copë kishte vlerën e një mëditjeje). Kësaj radhe përmendja erdhi nga pagani në tërësi të interesave personale. Përparimi i krishterimit e pengonte tregtinë. "Një argjendar, që quhej Dhimitër, punonte tempuj të vegjël të Artemidës dhe kështu u sillte fitesë që të vogël mjeshtrëve. Ky i bashkoi këta dhe të gjithë tjerët që merreshin me këtë veprimtari dhe u tha: Burra, ju e dini se



e gojë. Predikoi në sinagogë dhe e zgjoi xhelozinë e judenjëve, të cilët u munduan ta zënë, por ai u shpëtoi dorësh dhe kaloi në Berezë dhe më vonë ndoshta edhe në Athinë. Ajo që na mahniti në jetën e shën Pali është dashuria për popullin e vet. Ai prej tyre u përmend për vdekje në Damask, Listër, Derbë, Selanik dhe prapë do të shkruajë në Rom 9, 3: "Po, do të dëshiroja unë vetë të isha i mallkuar, i ndarë prej Krishtit, në vend të vëllezërve të mi, në vend të bashkëkombetarëve të mi për kah gjaku." Ky është paradoksi në madh i dashurisë.

Berezë (Vap 17, 10-15)

Me të arritur në Berezë Pali dhe Sila shkonin herë pas here në sinagogë. Shën Luka shkruan: "Këta ishin më zemërimë se hebrenjtë e Selanikut. E pranuan fjalën me gatishmëri dhe përditë e shqyrtorin Shkrimin shenjt pale a është ashtu (Vap 17, 11)." Por, hebrenjtë e Selanikut as këtu nuk i lanë vend Pali. Pali reagon shumë ashpër në këtë gjest në 1 Sel 2, 15-16: "Këta e vranë edhe Zotin Jezus dhe profe-

Kjo e irritoi popullin, i cili i tha Pali: "Në lidhje me këtë do të dëgjojmë një herë tjetër", gjë që e lëndoi shumë Palin. Duket se këtë qytet e lëshuan pa qenë të detyruar, apo të përmendur.

Korint (Vap 18, 1-17)

Nga Athina Pali erdhi në Korint që ishte qytet i fëlligështisë. Tempulli i Afroditës i kishte rreth 1000 prostituta, që ishin në shërbim të Afroditës mitologjike, hyjnise së frytshmërisë. Askund Pali nuk predikoi mbi pastërtinë dhe virgjinë, si në këtë qytet të "papistër". Këtu u strehua të Akuli, me prejardhje nga Ponti. Punonte në profesionin e vet si mjeshtrë tendash, prej nga e siguronte bukën, për të mos u bërë barrë e askujt. "Pali për çdo të shtunë e merrte fjalën në sinagogë dhe mendohej t'i bindte hebrenjtë e grekët...Por, mbasi ata kundërshtojnë dhe blasfemionin, ai i shkundi petkat dhe u tha: "Gjaku juaj mbi krye tuaj! Unë nuk kam faj! Që tani unë po ju drejtohem paganëve! (Vap 18, 4-6)" U largua dhe banoi në shtëpinë

për kremtimin e Pashkëve, për t'u kthyer në Antioki. Kështu mbaroi udhëtimi i dytë misionar. Në 2 vite e gjysmë Pali i kaloi rreth 5000 km, nga të cilat 2000 i kaloi duke ecur këmbë. Gjatë këtij udhëtimit mendohet Pali të ketë kaluar edhe në trojet e Shqipërisë së sotme dhe të ketë themeluar kishën e parë në Durrës. Në fund të theksojmë se të dy letrat drejtuar selanikasve u shkruan gjatë muajit të parë të qëndrimit të tij në Korint.

Udhëtimi i tretë misionar (Vap 18,23 - 21:26)

Edhe kësaj here filloi nga Antiochia për Efes, qytet me 500.000 banorë. Kaloi nëpër qytete Tarz, Derbë, Listër dhe Ikon: "pastaj u nis të përshkojë krahinën e Galacisë e të Frigjisë duke i përfuruar në fe të gjithë nxënësit (Vap 18, 23)." Efesi kishte portin më të madh të Azisë së Vogël. Kapitulli 19 flet për tri ngjarje që kanë ndodhur në Efes gjatë qëndrimit të shën Pali në këtë kryeqytet të Azisë së Vogël. Ngjarja e parë (Vap 19, 1-10) ka të bëjë me dymbëdhjetë burra që

(vijuar nga faqja 15)

fitesa jonë varët nga kjo mjeshtëri, e po shihni se ky Pali, jo vetëm në Efes, por pothuaj edhe në mbarë Azinë, ia ka mgushur mendjen dhe e ka larguar një shumicë të madhe populli duke mësuar se nuk ka hyjni të punuar me dorë njeriu. Kështu, jo vetëm është në rrezik mjeshtëria jonë, por edhe tempulli i Artemidës, hyjneshës së madhe, s'ka për t'u çmuar me dhe do të mbarojë madhëria e asaj, të cilën e nderon krejt Azia dhe bota mbarë (Vap 19, 25-17). Duhet theksuar se më vonë afër këtij teatri u ndërtua bazilika e madhe ku u mbajt koncili i Efesit në vitin 431 i cili vendosi se Zoja e Bekuar është Hyjlindëse. Pas qëndrimit prej 2 vjet e gjash-të mua në Efes, ndoshta edhe më shumë (Vap 20, 31), shkoi në Maqedoni, prej ku arriti në Korint, ku e kaloi dimrin. Në pranverë kishte ndër mend të shkonte në Jerusalemin, rrugës detare, por kur mori vesh se judenjtë donin ta mbysinin, e ndryshoi planin dhe u kthye nga Maqedonia, rrugës tokësore. Shumë nxënës e përcillnin në dy grupe, apo pritim në Troadë, ku e ngjalli djaloshin me emrin Eutih. Nga Troada nëpër Ason, Militenë, Hijos dhe Sam arritën në Milet. "Nga Milet Pali dërgoi në Efes e i thirri të parët e kishës, të cilëve u mbajt një fjalim përsëritës shumë mallëngjyës (Vap 20, 17-35), sa që "të gjithë ia plaçen vajit". Pas këtyre fjalëve shën Pali lundroi për Kos, Rod, Patarë, Fenici dhe Qipro, prej nga kaloi në Siri. Aty udhëtoi në Tif, Ptolemaidë dhe ndaloi në Cezare ku "një profet që quhet Agab" i paralajmëroi se do ta arrestojnë. Katër letrat ma të rëndësishme shën Pali i shkroi gjatë këtij udhëtimi misionar: të parën e Korintasëve nga Efesi, diku në kohën e Pashkëve, të dytën e Korintasve nga Maqedonia, në verë, apo vjeshtë të po atij viti, letrën e Romakëve nga Korinti, në pranverën e ardhshme, ndërsa koha e shkruimit të letrës së Galatasëve nuk dihet me saktësi. Ishte ky një përshkrim i shkurtër i udhëtimeve misionare të shën Palit, që si mund të bindemi, kanë qenë të përcjella me shumë kryqe.

Po e përfundoj me një tregim të shkrimtares Hochman nga Zheneva, e cila tregon mbi një vajzë të re, e cila nga dukja e jashtme ishte e shëmtuar. Nana e saj në një moment hidhërimi u shpreh pa farë urtie: "Ty kurrë askush nuk ka për të dashur." Kjo që e goditi vajzën ishte thellë në zemër dhe e bëri të vuante tërë jetën. Megjithatë, nga kjo goditje ajo vendosi: "Do të jem ndaj gjithkujt shumë e kujdesshme dhe e dashur." Këtë edhe e realizoi dhe nga ky moment në jetën e saj gjithçka ndryshoi. Fati i buzëqeshi dhe ajo e martoi një burrë të ndershëm dhe u bë një shpianike dhe një nënë e mrekullueshme. Kur vdiq, burri ia shkroi këto fjalë në përmendore: "Kjo ishte engjëlli i jetës sime!" (Koch XII 765, 3). Vallë, s'është edhe shën Pali një rast i tillë?

"Zoti bën skamnore e të pasur, përul edhe lartëson..." (1 sam 2, 7)

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

Libri i parë i Samuelit e paraqet gjyqtarin e fundit të Izraelit, lindjen dhe rininë e tij në Tempull, sidomos historinë e Anës, e cila ishte gruaja e Elkanit, por që vuante shumë, sepse s'kishte fëmijë, ishte beronjë, ndërsa gruaja e tij e dytë, Fenena, kishte fëmijë.

Ana, e trazuar dhe e tronditur në shpirt për shkak të mungesës së fëmijëve, por edhe e ngacmuar dhe e fyer rëndë dhe vazhdimisht nga ana e Fenenës "nisi të qajë e s' deshi të bante. Atëherë Elkana, burri i saj, i tha: 'Anë, pse po qan e nuk ha? Përse po vuan në zemër tënde? Pse a nuk jam unë më i mirë për ty se t'i kishte dhjetë djem?' (1 Sam 7).

Me këto ndjenja ajo shkoi në Tempull në Silo dhe lutej me fe të gjallë kështu: "O Zot i gjithësisë, nëse priresh prej shërbëtores sate, mos e barro shërbëtores tënde e fali shërbëtores tënde një djalë. Unë atë do t'ia kushtoj Zotit për të gjitha ditët e jetës së tij dhe brisiku rrues nuk do të kalojë përmbi kokën e tij" (1 Sam 1, 11).

Mosruajtja e kokës ishte shenjë e kushtimit ndaj Zotit dhe kishte dy forma apo trajta: mosruajtjen e mospirjen e alkoolit.

Heliu, prifti i Tempullit të Zotit, duke e shikuar Anën se si i lëvizte buzët, por nuk fliste, mendoi se ishte e dehur, dhe e qortoi me fjalë të rrepta për kohëzgjatjen e uratës dhe për mospërfilljen e traditës, mënyrën e veprimt, sepse urata thuhej botërisht dhe me zë (krh. 1 Sam 12-16).

Sa herë edhe ne i përngjajmë Heliut, vlerësojmë, gjykojmë njëri-tjetrin sipas sjelljes së jashtme, pamjes, veshjes, moshës, gjinisë, fesë..., në stilin e farisenjve dhe me shumë paragjykimë dhe qëndrime të gabuara!

Mirëpo pas rrefimit të halleve të Anës, Heliu u prek në zemër, ndërroi mendimin e vet të gabuar dhe vetëm njerëzor, bëri një vlerësim dhe premtim hyjnor me këto fjalë: "Shko në pagë dhe Hyji i Izraelit ta plotësoftë kërkesën e bërë" (1 Sam 1, 17).

Mësim dhe qortim për ne: lypset së pari për ta dëgjuar tjetrin, sepse pa komunikim ndër-njerëzor s'ka as mirëkuptim, bashkëpunim, si dhe duhet të lutemi njëri për tjetrin, sepse urata do t'na hapë sytë e mendjes dhe

të zemrës për ta zbuluar dhe jetësuar të vërtetën dhe mbi të gjitha dashurinë.

Nga ky takim dhe bisedim mes Anës dhe Heliut pati shumë fryte. Heliu u lirua prej paragjykitimit dhe e kuptoi mirë dhe drejtë gjendjen e Anës.

Ana qajti dert, hall, së pari me Hyjin, pastaj edhe me Heliun, iu lut Zotit dhe u porosit edhe në uratën e Heliut.

Të dy pas këtij takimi, bisedimi dhe urate u lëshuan në dorën e Zotit: "Oh, sikur shërbëtorja jote të gjente hir para syve të tu!" "Gruaja shkoi në punë të vet, hëngri dhe fytira e saj nuk qe më si më parë" (1 Sam 1, 18).

Gruaja në atë kohë dhe sipas botëkuptimit hebrej ishte inferiorë ndaj burrit, mashkullit, aq më tepër kur ishte beronjë, s'kishte fëmijë, trajtohej si e mallkuar prej Zotit, pra, e debuar edhe prej Zotit edhe prej njerëzve.

Uratat e Anës në tempull nuk ishte sipas dokeve të atëherëshme, me zë, me formula apo fjalë të mësuar përmendsh, por në heshtje, me zemër, apo si tha vetë ajo: "E zbrazta zemrën time para Zotit" (1 Sam 1, 15).

Mu për këtë Zoti e dëgjoi lutjen e saj, si edhe uratën e Sarës, e cila mrekullisht e lindi Izakun (krh. Zan 21, 1-7).

Ana beronjë bëhet nënë me ndihmën e Zotit, sikurse edhe Virgëria Mari bëhet nënë "për virtyt të Shpirtit Shenjt" /Lk 1, 35-37/.

Në uratën e Anës gjenden elementet, "lënda e parë" e himnit "Shpirti im e madhëron Zotin", sepse para se të ndërhynte Hyji, gjendja ishte vërtet e mjerë.

Populli i Izraelit ishte i vogël, i dobët, i pambrojtur, me shumë rrezikime të vazhdueshme; gruaja (Ana) ishte beronjë, e nënçmuar dhe e poshtëruar nga të gjithë; vetëm Zoti mund të jetë, është, shpëtimtari i popullit dhe i beronjës.

Ana "Brenda vitit mbeti shtatzënë e lindi një djalë dhe ia dha emrin Samuel, sepse ia kishte hyrur me uratë Zotit" (1 Sam 1, 20).

Vetëdija se lindja e birit, Samuelit, ishte vepër e Zotit, e jo e njeriut, dhe falënderimi i saj për këtë dhuratë të madhe, janë të dukshme dhe të fuqishme. Ajo shkoi prapë në tempull, së bashku me të birin, për ta falënderuar, së pari Zotin, pastaj edhe Heliun, për mirëkuptim dhe uratën e tij, për t'ia paraqitur dhe kushtuar Zotit Samuelin, për ta



“Uratat e Anës në tempull nuk ishte sipas dokeve të atëherëshme, me zë, me formula apo fjalë të mësuar përmendsh, por në heshtje, me zemër, apo si tha vetë ajo: "E zbrazta zemrën time para Zotit" (1 Sam 1, 15).”

plotësuar njetin që kishte bërë.

"Atëherë Ana i tha: 'Më dëgjo, imzot. Pasha jetën tënde, unë jam gruaja që pati qëndruar pranë teje duke iu lutur Zotit. U luta për këtë fëmijë dhe Zoti ma plotësoi uratën time për çka iu luta. Prandaj unë po e jap në shërbim të Zotit; për sa të jetë gjallë i dhurohet Zotit'" (1 Sam 1, 2).

Pastaj vijon kënga e Anës, e cila i ka pothuaj të gjitha elementet e Magnificat-it.

Ja vetëm disa krahasime dhe paralelizma të dukshme:

"Zemra ime kërcen me gëzim në saje të Zotit... sepse më gëzoove me bamirësinë tënde" /1 Sam 2, 4/.

"Shpirti im e madhëron Zotin... sepse punë të mëdha bëri për mua Hyji..." /Lk 1, 47-49/.

"Harku i të fortit u thye, kurse të ligshbit u ngjeshen me fuqi!" /1 Sam 2, 4/.

"I rrezoi princat prej froneve të tyre e i lartësoi të përvujtët" /Lk 1, 52/.

"Të ngopurit rrogëtarë u lidhen për bukë goje, kurse të uriturit më s'provonjë skamje" /1 Sam 2, 5/.

"Me të mira i mbushi ata që s'kishin ç'të hanë e të pasurit i nisi duarthatë" /Lk 1, 53/.

"Zoti bën që të vdiset e të jetojnë plandos në Nënëtolë dhe andej nxjerr" /1 Sam 2, 6/.

"Si u pati premtuar etërve tanë - në të mirën e Abrahamit e të pasar-

dhësve të tij në amshim" /Lk 1, 55/.

Nga ky shqyrtim dhe meditim biblik, nxjerrim këto porosi për jetën tonë: Fuqia e Zotit dëshmohej në ligështi, në dobësi dhe në vogëlsi, në përvujtëri; Njeriu duhet t'i pranojë veprat e Zotit dhe ato lypset t'ua shpallin edhe të tjerëve, të gjithëve; Njeriu, besimtari, duhet të jetë i falënderueshëm për çdo dhuratë dhe hir, së pari ndaj Zotit, pastaj edhe ndaj të tjerëve. Ana kthehet në Tempull te prifti Heliu, e kryen premtimin dhe kushtin e dhënë, e kushton djalin e saj Samuelin Zotit dhe Tempullit të Zotit. Ajo nuk kushtoi në Tempull çka do, por birin e dëshirës, me të çmuarën e jetës së saj. Edhe ne lypset kushtuar dhe dhuruar Zotit gjithçka, tërësinë e jetës sonë, apo si do të thoshet e Lumja Nënë Tereze "Jepe pjesën më të mirë të vetvetes!".

Fuqia e uratës është e madhe, e mrekullueshme, sidomos kur nuk është vetëm fjalë goje, por gufim zemre, e frymëzuar nga feja dhe e përcjellë nga dashuria. Edhe më tepër bie në sy urata e përbashkët, për njëri-tjetrin, të cilën edhe Jezusi na e mëson dhe e premtim këtë: "Sepse ku janë dy ose tre të bashkuar në emrin tim, aty jam edhe unë, midis tyre" /Mt 18, 20/.

ABC-ja bashkëshortore – martesore (II)

PËRGATITI:
P. Shtjefën Dodes S]

Të jetosh i/e lumtur një jetë të gjatë me një njeri që e do, është gjë e arritshme! Duhet pranuar se këtu duhet pak veprim dhe angazhim. Dashuria në rastet shumë të rralla mund të funksionojë vetvetiu – të paktën jo gjithmonë. Edhe pse kjo nuk tingëllon jo edhe aq romantike, ia vlen të investosh pak angazhim në partneritetin tuaj. Me këtë "ABC-ja bashkëshortore – martesore" mund të fitoni në këtë drejtim shumë nxitje.

J - jeta e përditshme; K - kërcënimet (mobingu); L - ledhatimi (përqafimi); LI - llafosjet (mosmarrëveshjet); M - martesë; N - ndershmëria (sinqeriteti); Nj - njohja (pranimi); O - origjinaliteti (personaliteti);

J - jeta e përditshme

Jeta e përditshme (bashkëshortore) i ka hilet e veta: çifti mësohet me njëri-tjetrin dhe ajo çka ka qenë në fillim ndoshta plot nxitje kjo në përditshmëri ndoshta mund të na shkojë në nerva. Rreziku që ta marrim njëri-tjetrin si gjë e vetëkuptueshme është i madh. Thjeni jetën Tuaj të përditshme duke të shkuar mendja sërishtmi të tjetri, për ta befazuar tjetrin. Ndërmerrni prej kohe në kohë diçka krejt të veçantë. Dhe: mësoni jetën e përditshme së bashku, për ta çmuar besimin dhe ndjenjën e sigurisë. Pikërisht kjo e karakterizon një marrëdhënie jetëgjatë.

K - kërcënimet (mobingu)

Ekzistojnë një numër njerëzish që në konflikt i kërcënohen partnerit të vet se do ta lëshojë atë. Në marrëdhënie të tjera di-kush e shfrytëzojnë fuqinë e vet fizike apo fuqi tjera ekzistuese për ta kërcënuar partnerin e vet. Mirëpo kush kërcënon luan me flakë. Kërcënimet në jetën bashkëshortore janë një gjë shumë e rrezikshme, sepse ai që e ndjen veten të kërcënuar nuk mundet të ketë besim. Kurse të besuarit është bazament i një partneriteti funksional.

Formën specifike të sjelljes me të cilën partnerët bashkëshortor në nivelin e marrëdhënieve të ndërsjella, të komunikimit dhe emocioneve e keqtrajtojnë dhe nënçmojnë njëri-tjetrin me qëllim të kërcënimit të imazhit, nderit, dinjitetit njerëzor dhe integritetit të tij/saj e quajmë mobing bashkëshortor. Viktima e mobingut bashkëshortor më së shpeshti është e pafuqishme, në pamundësi për t'u mbrojtur. Mobingu zgjatë në intervale një kohë të gjatë. Mesatarisht koha e zgjatjes para reagimit të viktimës është 15 muaj. Mobingu duhet ta dallojmë prej stresit të përditshëm në martesë. Viktima druan për t'u mbrojtur, sepse ka frikë. Nuk mund ta marrë fjalën apo vazhdimisht ndërpritet në bisedë. Nuk merret para sysh, sikur të mos ekzistonte. Viktima fajësohet për lëshime që objektivist nuk kanë ndodhur, për atë çfarë tunduesi fshehurazi me qëllim e ka bërë. Me pa baza janë të nënçmuara rezultatet e punës së saj.

Mobingu bashkëshortor

është shoqëruar i moskultivimit të marrëdhënieve bashkëshortore, komunikimit dhe dashurisë. Ai në shumë raste është pasojë e domosdoshme e martesave "të shpëtuara" nga jashtë me "divorc të brendshëm" dhe, kuptohet, me një mënyrë të gabuar të mbijetesës në një situatë të padurueshme bashkëshortore.

L - ledhatimi (përqafimi)

Kur e keni përkëdhelur partnerin Tuaj apo partneren Tuaj herën e fundit, pa pasur më atë rast ndër mend marrëdhëniet intime? Në shumë marrëdhënie jetëgjatë çiftet e kanë ndërprerë së zbatuari edhe në jetën e përditshme të shkëmbejnë ëmbëlsi. Shpesh herë marrin ledhatime vetëm atëherë kur është në pyetje seksi. Mos bëni kështu. Të gjithë ne kemi nevojë për dhurim ëmbëlsie dhe përkëdhelje dashamirësie. Kjo i bën mirë shpirtit tonë, krijon afërsi dhe lidhë.

Kur jeni lëshuar herën e fundit me kënaqësi në duart e dikujt? Një përqafim i ëmbël e megjithatë i fortë mund të japë aq shumë mbështetje dhe siguri. Përqafimi njëri-tjetrin jo vetëm kur jeni së bashku në shtrat apo kur njëri prej Jush ka nevojë të madhe për ngushëllim. Përqafimi njëri-tjetrin gjithmonë prej kohe në kohë. Kjo afërsi thjesht bën mirë.

LI - llafosjet (mosmarrëveshjet)

Të bisedosh me njëri-tjetrin është shtyllë kryesore mbështetëse e një marrëdhënie. Nuk është e thënë që Ju të bisedoni orë e cast, sepse edhe një hesh-tje e përbashkët mund t'ju lidhë shumë. Mirëpo fjala është që të bisedimet e përbashkëta gjithmonë të ndërmjetësohet ajo se ku tjetri ndodhet dhe si po ka-lon, dhe njëkohësisht fjala është për t'u shprehur se si po e ndjen njeriu veten dhe ndoshta për çfarë ka nevojë. Mos lejon që në partneritet të vijë deri te ajo që - siç mund të lexohet gjithnjë në-për statistika - Ju të bisedoni me njëri-tjetrin mesatarisht vetëm 8 minuta në ditë.

Më së pari çiftet bashkëshortore duhet të jenë të informuara



ka. Në vetë marrëdhëniet jetëgjatë mund të vijë deri te mosmarrëveshjet - nga njëherë mu atëherë, sepse jemi tepër të sigurt se e njohim tjetrin. Për këtë arsye mos jini kurrë tepër të sigurt dhe pyetni më shumë se sa tepër pak. Nëse e vëreni se jeni keqkuptuar sqarojeni këtë menjëherë. Sa më shumë të pritni me këtë aq më të këqija mund të jenë pasojat e të qenit i keqkuptuar.

M - martesë (vërja kurorë)

Për shumë vetë martesë është ende kurorëzimi i një marrëdhënie serioze. Dhe vërtet është një ritual i mrekullueshëm së bashku për ta bërë këtë hap. Mirëpo më atë rast duhet të dytë ta kenë të qartë që martesë është edhe një premtim. Premtimi për të jetuar së bashku. Natyrisht se nuk e di asnjëri se si do të rrjedhin gjërat, mirëpo vullneti dhe vetëdija për këtë premtim duhet të jenë të pranishme. Nga jeta e përditshme e dimë çka domethënë edhe një ndarje krejt e zakonshme që e përjetojmë si mjaft të dhimbshme, e mund ta marrim me mend se çfarë do të ishte një divorc.

N - Ndershmëria (sinqeriteti)

Konfliktet dhe grindjet nuk do të treten tërësisht në asnjë marrëdhënie. Madje është shumë me rëndësi që disa konflikte të vogla dhe të mëdha të shohiten hapur. Vetëm për një gjë do të duhej të mundoheni gjithmonë: të qëndroni fer. Ai që e njeh veten shpesh herë ka edhe mundësitë që ta lëndojë shumë tjetrin me anë të dijes së vet. Në vrullin e konfliktit kjo edhe mund të ndodhë. Atëherë do të duhej menjëherë të kërkoni ndjesë. Nganjëherë nuk mjafton vetëm që të kërkoni falje. Nëse nuk kemi qenë fer ndaj njeriut që na do është me rëndësi që për këtë plagë të përkujdeseni, në mënyrë që ajo të shërohet dhe kurrë më sërisht të ngacmohet.

Ata që e donë njëri-tjetrin do të duhej të jenë të sinqerë ndaj njëri-tjetrit. Kjo nuk do të thotë që çdonjëri duhet patjetër t'i dalë para me shpirt lakuriq që të flas gjërë e gjatë për shpirtin e

vet. Është krejt në rregull madje edhe e rëndësishme që çdonjëri të ketë lëmi për vete për të cilat ai/ajo nuk tregojn asgjë apo jo shumë. Sinqeriteti pra nuk domethënë "t'i tregosh të gjithat". Sinqeriteti lind nga vëmendja e treguar ndaj tjetrit përballë nesh, i cili për shembull nuk na lë të premtojmë atë çka nuk mund ta mbajmë. Të jesh i ndershmë do të thotë tjetrit t'ia thuash të vërtetën dhe asgjë të fshehësh nga ajo që është me rëndësi të madhe për të dytë. Këtë formë të ndershmërisë ia kemi borxh njëri-tjetrit.

Nj - njohja (pranimi)

Një prej gurë themeleve të një partneriteti funksional është pranimi (akceptimi). Për fat të keq si duket me kalimin e kohës shumë njerëz pikërisht te partneri e harrojnë këtë gurë themel të rëndësishëm. Ne më mirë jemi të gatshëm t'i pranojmë njerëzit e huaj me dobësi dhe gabimet e tyre se sa njerëzit me të cilët e kalojmë jetën tonë. Këtu grindemi me njëri-tjetrin orë e cast, nuk jemi të kënaqur dhe shohim vetëm atë që është negativ. Mos bëni kështu. Natyrisht se është me rëndësi po ashtu të flisni shtruar midis jush nëse Ju pengon diçka përmijemend. Mirëpo nuk ishte dashur që të kape-ni për çdo imtësi që ndoshta nuk u përshtatet krejt parafytyrimeve Tuaja. Pranoni partnerin Tuaj apo partneren Tuaj - ashtu si është.

O - origjinaliteti (personaliteti)

Çdo çift e sjell me vete krejt personalitetin e vet në marrëdhënien bashkëshortore. Edhe atëherë kur çiftet me vite të tëra jetojnë së bashku dhe jetën e tyre e ndajnë me njëri-tjetrin kanë të drejtë për ta mbajtur personalitetin e tyre të veçantë - origjinalitetin e vet. Është e vërtetë se shumë çifte me kalimin e kohës bëhen gjithnjë e më të ngjashëm, mirëpo prapë se prapë ne mbesim gjithmonë vetvetja, origjinal. Ruajeni te dytë krejt me vetëdije personalitetin tuaj të veçantë, respektojeni atë të tjetrit. Leo Buscaglia thoshte: "Të duash domethënë të krijosh një "Ne" pa e prishur një "Unë". A nuk do të mund të ishte kjo një model edhe për partneritetin Tuaj?

Të rinjtë dhe të tjerët?

Nga Ungjilli sipas Markut 10,17-24

Djaloshi pasanik

"Kur doli në rrugë, një njeri u lëshua vrap, ra në gjunjë para tij dhe e pyeti:

Mësuesi i mirë, çka duhet të bëj për të fituar Jetën e pasosur? Jezusi iu përgjigj:

Pse me thua: i mirë? Askush s'është i mirë përveç Një Hyji të vetem! Urdhërimet i di: Mos vra! Mos the kurorën! Mos vidh! Mos dëshmo rrejshëm! Mos bëj kurrfarë padrejtësie! Ndero babën tënd e nënën!

Ai i përgjigjet: Mësues, të gjitha këto i kam zbatuar që prej rinisë sime.

Atëherë Jezusi e shikoi ëmbël, i pelqeu dhe i tha:

të mungon edhe një gjë: shko shit çka ke, ndaj skamnorëve e do të kesh thesar në qiell, atëherë kthehu e eja pas meje! Djalo-shi u prish kur i dëgjoi këto fjalë e, i trishtuar, u largua, sepse kish-te prona të shumta.

Jezusi, pasi e hodhi shikimin për rreth, u tha nxënësve të vet:

Sa vështirë do të hyjnë pasanikët në mbretërinë e Hyjit.

Nxënësit mbetën shtang të habitur prej këtyre fjalëve të tij. Por Jezusi foli përsëri dhe u tha: "Bijte e mi! Sa vështirë është të hyhet në Mbretërinë e Hyjit!"

Shembulli i mirë për atë se si mund të hyjmë në mbretërinë qiellore përmes punës. Shembulli i mirë na jep e Lumja Nëna jonë Terezë, e cila të jetën e vet u kushtoi njerëzve të varfër, të gërbulur, ku shumica prej tyre vdisnin si të pashpresë nëpër rrugë, të përjashtuar nga familja dhe shoqëria. Nëna jonë Terezë asnjëherë nuk mendoj se çfarë mund të bëj unë me këta njerëz? Por ajo menjëherë filloi të mendoj se çfarë mund të bëj për këta njerëz duke iu dalë në ndihmë në mënyra të ndryshme, duke dhënë një dëshmi të madhe të krishterë. Ajo jo vetëm që u ndihmonte të varfërve, por edhe donte të jetonte si ata dhe për këtë arsye ajo zgjodhi edhe veshjen e sarit, e cila ishte një veshje e grave të varfra të Indisë, në mënyrë që të ndjehet e varfër ndër të varfër.

Me këtë ajo na tregon se si njeriu duhet t'u ndihmojë njerëzve që janë në nevojë. Nuk mjafton vetëm ndihma, por edhe bashkëndjenja dhe solidariteti me ta.

Më mirë të jesh në bord!

Në samitin e Aleancës Atlantike të mbajtur nga data 5 - 10 Prill, me më shumë se 25 kryeta-

rë shtetesh, presidenti Obama ka mbajtur një konferencë shtypi, dhe është përgjigjur në pyetjet e disa të rinjve të Evropës, të cilët patën dëshirë ta takojnë. "Nuk ka gjë më fisnike sesa shërbimi publik", ishte thënia e tij për të cilën u shpjegoj të rinjve: "Nuk do të thotë se duhet të vraponi për tu bërë president. Mund të angazhoheni në organizatën "Mjekët pa Kufij", të bëni punë vullnetare, të punoni për Organizatën e Kombeve të Bashkuara apo të jeni kryetar komune i Strasburgut... Çështja është se nëse mendoni vetëm për vetveten - sa para mund të fitoj, çfarë mund të blej, sa e bukur është shtëpia ime ose makina ime - pastaj edhe jeta mund të bëhet monotone... Për të jetuar një jetë të plotë, duhet të mendosh: çfarë mund të bëj për të tjerët? Si mund të jem pjesë e këtij projekti më të gjerë për të pasur një botë më të mirë?...Sidomos ju të rinj, shpresoj që keni menduar se si mund të jeni të dobishëm, sepse bota sot përballet me kaq shumë sfida dhe ka shumë mundësi për të bërë një ndryshim; kështu që do të jetë një tragjedi nëse të gjithë ju me plot talent dhe energji, t'i lini që të konsumohen, duke qendruar në një anë, ndërsa bota ju ecë përpara. Më mirë të hipësh në bord, të merrni pjesë... Ndonjëherë do të thotë që do të jeni të kritikuar, të dëshonin apo të zhgënjeheni, por do të jetoni një aventurë të vertetë dhe në fund të jetës suaj shpresoj që do të mund të shikoni mbrapa dhe të thoni: edhe unë kam bërë ndryshim".

Një shaka, që nuk do të duhej ta pranionim, thotë: "Ndaloni botën: dëshiroj të zbris!". Nuk ka nevojë për të zbritur: është më mirë të jeni në bord, thotë Obama.

Duhet t'i shtyjme të rinjtë tanë të interesohen për problemet e mëdha dhe mos të thuhet: Çka më intereson?!, - duhet të japim një kontribut të vogël, por me rëndësi, me vendosmëri në vendin e duhur, në klasën tonë, midis shokëve; duhet të jemi të fort për të ecur përpara përkundër stuhisë duke u përgjigjur pozitivisht në pyetjen. "Çfarë mund të bëj unë për të tjerët?".

Si shoqëri me probleme të shumta duket se të rinjtë nuk jetojnë një jetë as për vete dhe as për të tjerët.

Nëse ndalemi vetëm për një çast dhe mendojmë, se çfarë mund të bëjmë ne për të tjerët? Atëherë në mendjen tonë na shfaqen shumë pyetje nga me të ndryshmet si: mund të vizitoj një të sëmure, një të burgosur, personat me aftësi të kufizuara, njerëzit



me sëmurdje të pa shërueshme, mund t'i ndihmoj shokut apo shoqes, mund të kaloj një vikend me gjyshërit e mi duke bashkëndarë përfjetimet dhe përvojat e tyre në jetë, mund të bëj punë vullnetare me fëmijët e braktisur, mund të ndaj nga buxheti im i vogël një pjesë të të hollave (sa për një kafë ose një pako duhan në ditë) dhe t'u dhuroi të varfërve etj. Mendimet mbrojnë dhe sikur përgjigjet zbehën. Në vend që ato mendime të zbatohen duke ju ndihmuar këtyre njerëzve, tek ne ndodhë e kundërta, mbesim indiferent ndaj këtyre vuajtjeve dhe bëjmë një jetë të zbrazët. Pse ngurojmë që të bëjmë diçka për të tjerët? Ndoshta jemi të frikësuar që të japim qoftë edhe një ndihmesë shumë të vogël, apo ndoshta tek ne mbretërojnë mendime: Çka mund të bëj unë në këtë vuajtje? Kot është të mundohem, asgjë nuk mund të ndryshoj?!!

Në jetën tonë ne mund të bëjmë shumë gjëra por mund ta kemi si parim shërbimin, ky shërbim mund të jetë i dedikuar një grupi të caktuar njerëzish të lënduar, me një fjalë të gjithë atyre njerëzve në nevojë ose që kanë nevojë për ndihmën tonë.

Të organizohet koha, është një veprim i logaritur me mend sepse, të gjitha ndoshta mund të kthehen ndonjë ditë po, vetëm kohën nuk e kthejmë dot mbrapa. Ta organizojmë kohën e lirë mendoj se në radhë të parë do të ishim të dobishëm jo vetëm për veten tonë, por edhe për të tjerët. Duke u angazhuar vullnetar gjatë formimit tonë si person përveç se do të ndihmonim të tjerët por, do të përfitonim edhe duke e zhvilluar vetëbesimin tonë, do të ishim më konstruktiv, më të përgjegjshëm, do të rriteshin aftësitë tona personale dhe do të krijonim shumë eksperiencë të



reja.

Ditë për ditë na shtrohet pyetja: - Çfarë na shtynë që të jemi indiferent ndaj botës që na rrethon? Mos ndoshta vetëdija jonë e lartë se përmijmënd duhet ndihmuar njeriun në nevojë, mungesa e kohës së lirë, injoranca jonë apo mos shprehja e shërbimit alternativ.

Puna vullnetare ose angazhimi në kohën e lirë vlerësohet jashtëzakonisht në shtetet e zhvilluara. Të ne një numër i vogël i të rinjve e aplikojnë këtë gjë. Në ditët e sotme ka mundësi të mëdha të bashkëpunimit apo shërbimit në segmente të jetës si p.sh kujdesi shtëpiak për të sëmurë, shëndetësia, arsimit, ekonomia, ekologjia, etj., aty ku njerëzit ndihen më së miri aty edhe do të kontribuojnë më së shumti.

Të gjithë pa dallim moshe mund të kontribuojnë për vendin dhe shoqërinë tonë. "Të jemi një pikë ujë në oqeanin e madh" dhe të ndryshojmë gjërat për të mirë dhe të fillojmë bashkëpunimin duke filluar nga familja, shoqëria, vendi ku jetojmë dhe të zgjerohim secilën herë aktivitetin.

Kurse të rinjtë kanë mundësi të zgjedhin se ku do të kontribuojnë.

Një fjalë e urtë popullore thotë: "KUSH PUNON FITON", kjo bënë që njeriu ta kuptoj më mirë vetën se ku vlen në të vërtetë dhe sa vlen për atë kohë sa është në jetë.

(Shkruar nga:
Salezianët Bashkëpunëtorë)

Një ditë në metro të Washingtonit

Në metro D. C. të Washingtonit rrinte një njeri dhe i binte violinës. Ish-te mëngjesi i ftohtë i dhjetorit. Violinisti ekezekutonte rreth 45 minuta gjashtë vepra më të famshme të Bachut. Pasi ishte dita e punës, atë mëngjes andej, nëpër atë stacion, kanë kaluar të paktën 1000 njerëz. Shumica prej tyre shkonin në punë.

Pas nja tre minutave, një njeri i moshës mesatare e vërejtë violinistin, e ngadalësoi pakëz hapin, u ndal disa sekonda, e atëherë shkoi me shpejti për të arritur me

Askush nuk dinte se ai violinist ishte **Joshua Bell**, njëri prej muzikantëve më të mëdhenj të botës. Ai ekezekutonte veprat më të mira që ndonjë herë ishin shkruar për violinë. I ekezekutonte në violinën që kushtonte 3,5 milionë dollarë. Vetëm dy ditë para kësaj ngjarjeje Joshua Bell mbante koncertin në teatrin e Bostonit. Bileta kushtonte **100 dollarë**. Të gjitha biletat u shitën shumë shpejt, dhe nuk kishte njaf!

Kjo ishte ngjarje që me të vërtetë ka ndodhur. Joshua Bell



kohë atje ku ishte nisur. Pak më vonë violinisti pa dollarin e parë, që ia gjuajti në kuti një grua, pa u ndalur aspak. Pas disa minutave dikush u mbështet në mur për ta dëgjuar, por pak më vonë shikoi orën dhe vazhdoi rrugën – sepse sigurisht do të vononte në punë.

Vëmendjen më të madhe ia tregoi një djalosh trevjeçar. Nëna e nxishte për t'u ngutur, por fëmija u ndal për ta dëgjuar muzikën. Nëna e tërhoqi për dore dhe fëmija shkoi pas saj duke u kthyer vazhdimisht kah muzikanti. Njësoj kanë reaguar edhe disa fëmijë të tjerë, por prindërit e tyre të gjithë pa përjashtim i detyruan të vazhdojnë rrugën.

Gjatë 45 minutave vetëm gjashtë njerëz u ndalën për të dëgjuar pakëz muzikën. Rreth 20 veta kanë dhënë të holla, por kanë vazhduar ecjen me të njëjtën shpejtësi. Violinisti bashkoi gjithsej 32 dollarë. Kur e ndali muzikën, u bë qetësi absolute. Askush nuk duartrokiti, as nuk tregoi kurrfarë emocioni.

Miku më i mirë!

Fëmijë të dashur!

Së shpejti do të fillojnë pushimet, kur shumica prej jush udhëton, njoftohet me njerëz të rinj dhe me vise tjera, ende të panjohura. Disa këtë kohë e shfrytëzojnë për të lexuar dikëlla më tepër se gjatë vitit shkollor.

Gjatë kohës së pushimeve kemi më shumë kohë për miq... Por shumicën prej tyre kërkojmë kot, sepse kush e di se ku janë: në det në Velipojë, apo në Ulqin, te daja, apo në fshat...

Vetëm një mik, mikun më të mirë, mund ta gjejmë në çdo

kohë dhe mund të dëgjojmë fjalën e tij... Ai na pret gjithmonë dhe do të jetë shumë i pikëlluar në qoftë se gjatë pushimeve nuk do ta vizitojmë në shtëpinë e tij...

Ju vetë e dini se kush është ky mik: **JEZUSI!** Ai nuk ka pushtim vjetor. Ai vazhdimisht na pret ne. Shkoni tek Ai. Vizitojeni çdo të diel. Dëgjojeni fjalën e tij. Do ta gjeni kudo të shkoni: në çdo fshat dhe në çdo qytet, në çdo kishë dhe në çdo kapele. Pra, shoqërohuni me të vazhdimisht. Ai do të gëzohet dhe do t'ju gëzojë edhe ju.

Mini test

„Dua“ – „nuk dua“ në këtë verë

Dua – nuk dua; dua – nuk dua... Këto janë fjalë të shpeshta në fjalorin fëmijëror. Shpesh herë ju i thoni me zë. Ndoshta edhe më shpesh i thoni në vete... Ai „dua“ nuk është gjithmonë i lehtë. Ai „nuk dua“ nuk është i dëshirueshëm për veshët e prindërve, mësuesve dhe edukatorëve.

Në këtë test puna qëndron ndryshe. **Këtu ka vend edhe për „dua“, edhe për „nuk dua“.** Vetëm duhet t'i vëni në vend të duhur. Këtë punë do ta kryejnë më lehtë ata që rregullisht kanë marrë pjesë në Meshën e shenjtë dhe që kanë dëgjuar se çka u porosit Jezusi në shëmbulltyrat e veta... Mirëpo, për të gjithë ju më e vështira punë do të jetë që të silleni gjatë kësaj vere dhe përndryshe gjatë jetës suaj pikërisht ashtu sikurse kërkojnë përgjigjet e sakta.

Në vizë para çdo fjalie shkruani fjalën e duhur: „Dua“ ose „Nuk dua“... Pra:

Gjatë kësaj vere:

1) _____ të jem sikur pesë virgjëra të urta.

2) _____ të jem sikur ai djalë (nga shëmbëlltyra për dy djem, që babai i ka dërguar të punojnë në kopsht), i cili i ka thënë babait: „Dua“.

3) _____ të jem si ata që në tryezën dasmore ulen në vendet e para, në vende më të mira.

4) _____ të jem porsi egrira në arë.

5) _____ të jem porsi fara e mbjellë në rrugë pranë arës.

6) _____ të jem sikur delja „e njëqindtë“...

7) _____ të jem sikur shtëpia e ndërtuar në rrëzë.

8) _____ të jem sikur kopshari, që mihte dhe plehëronte tokën rreth fikut të pa fyt.

9) _____ të jem sikur shtëpia e ndërtuar në shkëmb.

10) _____ të jem sikur ai që në dasmë zë vendin e fundit, që nuk bie në sy.

11) _____ të jem sikur ata punëtorë që të parët erdhën për të punuar në vresht.

12) _____ të jem sikur fara që ka rrënë në tokë të mirë.

Përgjigjet e sakta janë këto: „Dua“ – nr. 1, 8, 9, 10 dhe 12. Të gjitha të tjerat janë: „Nuk dua“.

Në qoftë se nuk i ke të sakta së paku 8 përgjigje – atëherë gjithsesi merr Biblën (Besëlidhjen e Re) dhe prapë lexo shëmbëlltyrat dhe krahasimet e Jezusit!

A e dini se!

Shkencëtarët kanë llogaritur se njeriu përafërsisht një të tretën e jetës e kalon në gjumë.

Ky rezultat u arrit, pasi që nevojat për gjumë ndryshojnë gjatë jetës.

Fëmijës së porsalindur i duhet më shumë se një gjysmë dite gjumë dhe fle prej 18 deri në 20 orë.

Fëmijëve më të rritur (këtu bëjnë pjesë fëmijët që shkojnë në shkollën fillore) u duhet të flenë 10 deri në 11 orë.

Të rriturve u nevojiten 7 deri në 9 orë, ndërsa të moshuarve u mjaftojnë 5 deri në 7 orë, që shpesh herë varet edhe nga problemet shëndetësore që „nuk i lenë të flenë“.

Mendoni për këtë tani sa jeni të ri dhe kur aq shpesh mundoheni t'i 'kapërceni' netët, duke ndenjur deri vonë në lojë ose duke i zgurdulluar sytë në ekranin e kompjuterit ose të televizionit...

Fleni aq sa keni nevojë, edhe për shkak të shëndetit, por edhe pse do të vijin vitet kur nuk do të mundeni të flini aq gjatë dhe aq ëmbël.




Detyrë për ministrantë

Gjatë shërbimit të tyre në kishë, ministrantët takohen me simbole dhe objekte të ndryshme.

Në katër drejtkëndëshat e vegjël gjenden fotot me nga pesë objekte që në ndonjë mënyrë kanë lidhje me shërbimin e ministrantëve.

Këta katër drejtkëndësha janë të „prerë“ prej tabelës së madhe, dmth se elementet e tyre gjenden diku në këtë tabelë në të njëjtën renditje, por që mund të jenë në drejtime të ndryshme: horizontalisht, vertikalisht, në diagonale. Është me rëndësi që radhitja e elementeve të jetë e njëjtë si në drejtkëndëshat e vegjël.

Gjeni katër drejtkëndëshat e vegjël në tabelën e madhe!




(Përgatiti: Patër Ilija Kovačević)



TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

Faleminderit!



Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.

